



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Posaçëm për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 08.05.2018, ora 09.00

Drejtojnë mbledhjen:

Oerd Bylykbashi – bashkëkryetar i Komisionit

Bledar Çuçi –bashkëkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Konferencë me temë “Reforma Zgjedhore: Financimi i Partive Politike dhe Fushatave Zgjedhore”

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Ermonela Felaj, Alket Hyseni, Adnor Shameti, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Bashkim Fino, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Luan Rama, Fatmir Mediu dhe Nard Ndoka.

Mungojnë:

Musa Ulqini, Nasip Naço, Vangjel Dule dhe Dashamir Shehi.

Të ftuar:

Claus Neukirch – Kryetar i Këshillit të Europës në Tiranë

Monika Bylaite – Shefe e Zyrës Politike të Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri

Dr Quentin Reed, Ekspert i Këshillit të Evropës

Zj. Nicola Schmidt, Eksperte e OSBE/ODIHR

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi – Mirmëngjesi të gjithëve! Duke ju uruar mirëseardhjen, po fillojmë këtë mbledhje të Komisionit për Reformën Zgjedhore në një format, më të cilin, tashmë, besoj se po mësohemi, pasi është një format më i zgjeruar. Është një nga mbledhjet, për të cilat kemi rënë dakord kur miratuar platformën në komision për çështjen që do të ndjekim. Sipas mënyrës dhe kalendarit që kemi miratuar, kjo mbledhje është e dyta në radhë.

Sot do të flasim për financimin e partive dhe fushatave zgjedhore, që i takon pikës 4/2 të platformës. Shpresoj që të vazhdojmë dhe të ambientohemi më këtë format, pasi mendoj se vetëm kështu do të jemi më produktivë edhe në cilësi, edhe në kohë.

Ashtu si në mbledhjen e kaluar, sot kemi një prezantim nga një ekspert, që na është ofruar nga Këshilli i Europës, dhe gjej rastin ta falënderoj prezencën e Këshillit të Europës në Shqipëri. Pas prezantimit, do të kemi diskutime të hapura rreth të gjitha propozimeve që ka bërë eksperti, duke parë realitetin shqiptar dhe duke e krahasuar me legjislacionin rajonal, por edhe më gjerë. Janë të ftuar, përveç anëtarëve të komisionit, edhe ekspertët vendas dhe të huaj, përfaqësuesit e organizatave dhe të institucioneve që lidhen me çështjet zgjedhore, specifikisht me çështjen e financimit të partive. Në fund, i gjithë produkti, që do të dalë nga mbledhja, do të përpunohet dhe do t'u jepet menjëherë ekspertëve të komisionit për të na dhënë një variant, kuazi përfundimtar, për t'u ridiskutuar në komision për ta bërë gati që ta çojmë si paketë amendamentesh apo ndryshimesh të tjera rregullatore për të përmirësuar legjislacionin përkatës.

Ju ftoj të jeni sa më aktivë, në mënyrë që ta kemi sa më të plotë këtë produkt. Pa humbur kohë, ia kaloj fjalën bashkëkryetarit. Do të marrin fjalën për të përshëndetur edhe përfaqësuesit e Këshillit të Europës, pastaj do të fillojmë menjëherë nga puna.

Fjala është për ju.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Çuçi!

Edhe unë dua të theksoj rëndësinë e kësaj mbledhjeje në këtë format *ëorkshop-i*, që ka dy qëllime: së pari, për sa i përket inkluzivitetit, pra të përfshijmë në mbledhjet tona, të tërheqim në këto mbledhje, maksimumin e eksperiencës, problematikat që janë hasur nga institucionet që kanë zbatuar ligjin, aktorët e shoqërisë civile apo ekspertët që kanë identifikuar problematikat. Sigurisht, kjo duhet të jetë e ndërthurur me problematikat që kanë hasur partitë politike, të cilat marrin pjesë në mënyrë aktive në fushatë. Ato parti kanë këndvështrimet e tyre. Ky format do të

na japë mundësi që ta mbledhim këtë input, në mënyrë që komisioni më pas të jetë në gjendje të marrë vendimet e duhura për ndërhyrjet në lidhje me çështjen e financimit të procesit zgjedhor dhe të partive politike.

Së dyti, nëpërmjet këtij formati do të kemi mundësi që të eksplorojmë më thellë një nga tematikat kryesore, për të cilën kemi rënë dakord të gjithë në komision, që është çështja e financimit të partive politike, për shkak se gjithmonë e më shumë në të gjithë Europën financimi i partive politike po kthehet në një problem, në periudhë zgjedhore ose jo, i cili kërkon trajtime tashmë gjithmonë e më të plotë. Është e nevojshme, në këndvështrimin tonë, që të ketë një qasje të plotë, e cila do të çonte në një trajtim jo të pjesshëm, siç ka ndodhur deri më sot, pra Kod Zgjedhor veç, parti politikë veç, por të na japë mundësinë që me një këndvështrim 360 gradë t'i trajtojmë në mënyrën më të mirë të mundshme në legjislacionin shqiptar, që të mos lejohen hapësira, të cilat mund të shfrytëzohen nga aktorët e ndryshëm në proces për t'iu shmangur detyrimeve ligjore. Kështu, synohet jo vetëm një financim i shëndetshëm, ku përjashtohet paraja e paligjshme apo kriminale me ndikim negativ, shpeshherë të rëndë, në procesin zgjedhor, por të sigurohet edhe transparencja e plotë. Vërtet Shqipëria në të shkuarën i përputhi pothuajse të gjitha rekomandimet GRECO-s të Këshillit të Europës për sa i përket financimit, por zhvillimet kanë bërë që kjo kornizë ligjore të mos jetë me mjaftueshme, për rrjedhojë na duhet ta rishikojmë thelbësisht.

Këshilli i Europës ka qenë në avangardë prej kohësh në lidhje me këtë çështje, por edhe aktorë të tjerë kanë marrë pjesë vazhdimisht duke dhënë kontributin e tyre, për shembull NDA-ja, OSBE-ja me rekomandime nëpërmjet raporteve të saj. E rëndësishme është që pas debatit këtu, komisioni të arrijë në konkluzione për të bërë atë, që kërkon raporti i OSBE-ODIHR-it, pra që vendimmarrjet tona të jenë të bazuara në një politikë të qartë për trajtimin e problematikave. Nuk do të zgjatëm më tej, por si të gjithë të tjerët, do t'i rezervoj vetes kohën për të diskutuar për çështje specifike.

Duke falënderuar zyrën e Këshillit të Europës për asistencën që na jep në organizimin e këtij eventit dhe për sjelljen e ekspertizës së Këshillit të Europës në implementimin e axhendës së komisionit, dua t'i kaloj fjalën zotit *Claus Neukirch*, drejtuesi i zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë.

(Anglisht)

Claus Neukirch- Faleminderit shumë! Përshëndetje!

Mirëseerdhët në këtë takim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar, në të cilin ne po kontribuojmë me ekspertë dhe organizmin. Ajo çfarë duam të arrijmë sot është të vendosim një forum që do tju japë mundësinë të shkoni në themel të çështjeve për financimin e partive politike dhe fushatës zgjedhore.

Transparenca thuhet të jetë dezinfektuesi më i mirë. Mungesa e transparencës në financimin e partive politike dhe fushatën zgjedhore jo vetëm që krijon një mjedis për ndikim të paligjshëm dhe korrupsion, por gjithashtu kontribuon në mosbesimin e përgjithshëm ndaj qeverisë duke prekur kështu të gjithë sistemin dhe institucionet demokratike. Korrupsioni shihet jo vetëm si një kërcënim për biznesin ndërkombëtar apo interesat financiare, por për vlerat e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit që Këshilli i Evropës mbështetet.

Këshilli ka disa instrumente përsa u përket standardeve dhe mekanizmave të monitorimit në luftën kundër korrupsionit nga pikëpamja e së drejtës penale, civile dhe administrative.

Transparenca e financimit të partive politike është në qendër të raundit të tretë të vlerësimit të GRECO- e cila fton autoritetet shqiptare që të marrin masat e duhura për zbatimin e rekomandimeve.

Qëllimi i GRECO është të forcojë kapacitetin e anëtarëve të saj për të luftuar korrupsionin duke monitoruar përputhshmërinë e tyre me standardet anti-korrupsion të Këshillit të Evropës, duke vlerësuar masat e ndërmarra nga secili anëtar në përgjigje të gjetjeve dhe rekomandimeve të monitorimit dhe duke nxitur në mënyrë aktive reformën. Komisioni i Venecias po punon gjithashtu në çështjen e financimit të partive politike të cilat luajnë një rol themelor në jetën demokratike.

Përmes projektit të përbashkët të Bashkimit Europian / Këshillit të Evropës, "Veprimi kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri" (AEC-AL) ka kontribuar në forcimin e legjislacionit për Financimin e Partive Politike dhe fushatës Zgjedhore, duke ofruar rekomandime të caktuara për Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore me qëllim realizimin e një ndikim të qëndrueshëm të reformës zgjedhore.

Përveç kësaj, Këshilli i Evropës ka mbajtur dhe zhvilluar kontakte të rregullta dhe takime bilaterale me dy bashkëkryetarët e Komisionit të Posaçëm parlamentar për reformën zgjedhore, përfaqësuesit e KQZ-së dhe palët e tjera me interes lidhur me këtë çështje.

Për më tepër, Këshilli ka mbështetur Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të rritur kapacitetet e saj të mbikëqyrjes për auditimin e raporteve financiare nëpërmjet hartimit të formateve të standartizuara për raportet vjetore, raportet e monitorimit dhe raportet e auditimit të fushatës zgjedhore dhe ofrimin e trajnimeve.

Këto janë në mesin e shumë aktiviteteve të tjera të zhvilluara nga Këshilli i Evropës përmes Veprimit kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri që synon forcimin e kuadrit ligjor dhe rritjen e kapaciteteve të autoriteteve shqiptare përgjegjëse për mbikëqyrjen e partive politike dhe financimin e fushatës zgjedhore.

Shqipëria ka ndërmarrë tashmë disa masa për të rritur transparencën e partive politike dhe fushatës zgjedhore (Shtesat dhe ndryshimet e miratuara në maj 2017, ndryshimet në Ligjin për Partitë Politike, ndryshimi i Ligjit nr. 89/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", miratuar nga Parlamenti Shqiptar, Udhëzimet e miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Këshilli i Evropës do të vazhdojë të organizojë aktivitete që mbështesin reformën zgjedhore përmes organizimit të konferencave, seminareve dhe ofrimit të ekspertizës përmes Veprimit kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri dhe Komisionit të Venecias për tema të veçanta si (Votimi jashtë vendi, keqpërdorimi i burimeve shtetërore për qëllime elektorale, përdorimi i teknologjive të reja në votim, shitblerja e votës. Në bazë të kërkesës së Komisionit të Posaçëm duke koordinuar ngushtësisht me bashkëkryetarët e Komisionit dhe në bashkëpunim me parterët tanë ndërkombëtarë, *BE, OSCE/ODIHR dhe Prezencën e OSBE në Shqipëri.*

Reforma ka hyrë në një fazë të re ku nevojitet angazhimi juaj për të treguar se gjërat po lëvizin në drejtimin e duhur. Këshilli i Evropës përmes Komisionit të Venecias dhe AEC-AL, së bashku me partnerët tanë do ti ofrojnë këtij Komisioni mbështetjen e nevojshme për të siguruar që reforma do të jetë një paketë afatgjatë e ushqyer nga dialogu dhe kompromisi, duke marrë parasysh rekomandimet e Komisionit të Venecias, OSBE / ODIHR.

Nga ana jonë ne do ju ofrojmë forumin ku mund të diskutoni, ekspertizë dhe kontribut që do të ushqejë diskutimet, si edhe një rishikim të projektakteve ligjore. Çfarë ne do të shpresonim është të fillonim me këtë ëorkshop dhe takim sot dhe të vazhdoni me pjesëmarrjen tuaj aktive dhe u jam shumë mirënjohës dy bashkëkryetarëve të lëvizin procesin përpara dhe shpresojmë që siç e thashë edhe më përpara ne do të kemi një reformë elektorale që do të marrë konsensusin në Parlament dhe do të adresojë rekomandimet e lëna nga OSBE-ODIHR dhe Komisioni i Venecias

dhe do ti ofrojë Shqipërisë një legjislacion të qëndrueshëm që prek të gjitha fushat të cilat duhen rishikuar. Me këto fjalë dua tui uroj suksese, diskutime të mira dhe ëorkshop të mbarë. Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Neukirch! Tani, pa humbur kohë, do doja që të dëgjonim prezantimin e ekspertit, Z.Quentin Reed, i cili ka një eksperiencë të gjatë në Shqipëri, që prej 2009 dhe kjo është një garanci edhe për produktin pasi e njeh shumë mirë realitetin shqiptar, ndryshimet që ka pësuar legjislacioni, mënyrën se si zbatohet legjislacioni në Shqipëri. Problemet që ka shoqëria, politika shqiptare, kështu që besoj se këto janë një garanci për produktin që eksperti do na paraqesi sot edhe siç iu thashe më përpara është krejtësisht i hapur, fillimisht për diskutimet këtu brenda pasi edhe qëndrimet do jenë konkrete, Zoti Reed ka bërë një set amendamentesh, të cilat edhe do i shpjegojë dhe besoj se në mbledhjen e sotme, mbas mbledhjes së sotme të kemi një bazë të mirë për ekspertët pastaj të Komisionit për të na dhënë në draftet përfundimtare për të pasur një diskutim përfundimtar për ndryshimet, fjala për Ju Z. Reed.

Quentin Reed- (në Anglisht): Faleminderit bashkëkryerëve.

Së pari, për tu prezantuar të pranishmëve që nuk më njohin, quhem Quentin Reed kam punuar në fushën e anti-korrupsionit në Shqipëri për më tepër se 10 vite tashmë për tre projekte dhe një nga temat ku kam punuar ka qenë edhe financimi i partive politike, që nga 2009 dhe në vijim. Për mua kjo është një punë koherente në kuptimin e dhënies së paketës së plotë të ndryshimeve të propozuara. Në anën tjetër, duhet ta theksojmë këtë se para jush keni një dokument që duket si një paketë pothuajse e plotë paragrafësh të propozuar, jam munduar ta punoj në sa më shumë detaje ka qenë e mundur por është një dokument me sugjerime dhe nuk synon tui vendosë para faktit të kryer dhe kam që tani rezerva për të përsa i përket gjërave që i mungojnë dhe që duhet të diskutohen më tej. Pra ky është shpirti i dokumentit. Para jush keni një listë të ndryshimeve të propozuara të paragrafeve të paraqitura sipas radhës për dy ligjet më të rëndësishme Kodit Elektorale dhe Ligjit për Partitë Politike. Ekziston një version i dytë i këtij dokumenti që ka të njëjtën përbërje, por është i organizuar sipas temave. Do tui prezantoj në këtë mënyrë që të jetë më e kuptueshme për ta kuptuar, përndryshe do jetë shume e fragmentuar. Do tui marr me radhë temat dhe identifikoj ndryshimet kryesore.

Një temë madhore e propozimeve është se kur ka pasur ndryshime në 10 vjeçarin e fundit, kanë qenë vetëm në Ligjin për Partitë Politike, qoftë këto për të përmbushur

rekomandime të GRECO në 2011 apo ndryshimet që ndodhën në vitin e kaluar në Maj. Një nga pasojat e vitit të kaluar është se Ligji për Partitë Politike u ndryshua që të zbatohet me efektivitet Kodi Zgjedhor pasi ndryshimi i këtij të fundit ishte i vështirë. Një nga propozimet në dokumentin para jush është të hiqen ndryshimet e bëra në Maj të 2017 dhe të transferohen në Kodin Zgjedhor aty ku logjikisht edhe kanë vendin. Përveç kësaj e gjithë filozofia mbi rekomandimet krahasuar me vitet e mëparshme ku paraqiteshin të detajuara, tashmë pika e referimit është reduktimi i kostove. Shumë është arritur në ndryshimet e vitit të kaluar, por ka punë të pambaruar. Materiali sot sugjeron rekomandime si të plotësohet kjo punë.

Së fundmi në një aspekt më të përgjithshëm, përcaktimi se çfarë sistemi rregullator duam është shumë i rëndësishëm, nuk është e qartë se çfarë roli kanë audituesit e pavarur, apo kompetencash ka KQZ-ja për të verifikuar. Futja e një niveli tjetër auditimi vitin e kaluar siç ishin monitoruesit e fushatës zgjedhore e ka komplikuar edhe më tej sistemin. Propozimet synojnë ti japin qartësi.

Siç e theksova do e ndaj në tema për ta bërë më të lehtë.

Fillimisht në Kodin Zgjedhor, përcaktimi i shpenzimeve të fushatës zgjedhore është pika kyçe. Për momentin kjo nuk është bërë në ligj apo askund tjetër dhe ka pasojat negative, sepse për shembull nëse ka një kufi në shpenzime ose disa lloje shpenzimesh janë të kufizuara ose të ndaluara është e pamundur të zbatohet në rast se nuk ka përkufizim të shpenzimeve të fushatës. Këtë rekomandim këtu e kam ndryshuar disi që nga takimi i fundit. Të shtohet një paragraf që përkufizon shpenzimet e fushatave zgjedhore si “shpenzime të bëra nga një parti e regjistruar politike, duke përfshirë edhe shpenzimet e bëra për ose nga kandidatët e saj ose degët lokale, ose për/ nga një kandidat i pavarur për promovimin e partisë ose të kandidatëve të saj ose të një kandidati të pavarur në zgjedhje ose për të promovuar partinë ose kandidatët e saj në lidhje me zgjedhje të ardhshme relevante ose në përpjekje për të dëmtuar mundësinë e një partie tjetër ose të kandidatëve të saj ose të një kandidati të pavarur. E kam huazuar këtë përkufizim nga Kodi anez, praktik të cilën e nuk e përdor por mendo se ky përkufizim që vjen nga Britania e Madhe është shumë i mirë. Kjo e adreson çështjen e përkufizimit.

Së dyti, vendosja e një periudhe për qëllime raportimi mbi financimin, peroudhë më e gjatë fushate zgjedhore, Propozimi këtu është të përcaktohet si periudhë fushate zgjedhore 6 Muaj Nevojitet kjo sidomos përse i përket shpenzimeve, përndryshe mund të humbasin shumë asi shpenzimi mund të ndodhë shumë më herët apo edhe në fund të fushatës nëse shpenzimet

faturohen në at kohë dhe e njëjta gjë zbatohet edhe për donacionet. Duhet të përmendet këtu se edhe me këtë periudhë të zgjatur fushate për 6 muaj kur partitë dorëzojnë raportet financiare të fushatës zgjedhore ata duhet të raportojnë çdo gjë që ndodh gjatë atyre gjashtë muajve, por kohëzgjatja e periudhës zgjedhore është e diskutueshme, në Britaninë e Madhe është i gjithë viti në fakt, në disa vende është me e shkurtër. Edhe pasi e kemi përcaktuar këtë periudhë duhet shenuar se nëse shpenzimi ndodhi para kësaj periudhe në momentin që është me qëllim financimin e fushatës zgjedhore atëherë edhe ky shpenzim duhet të raportohet sipas formatit të standartizuar të miratuar nga KQZ të cilën e ndihmuam sëbashku me NDI në hartimin. Këto janë dy çështjet e përgjithshme, Tema e dytë është për subvencionet shtetërore, po flasim për Kodin Zgjedhor tashmë dhe i referohemi nenit 87/2. Do citoj nenet kështu që ju mund tu referoheni në versionin e dokumentit të plotë që keni para jush. Ka një problem për momentin që prek mënyrën sesi është parashikuar subvencionet shtetërore, Dispozitat aktuale paraqesin një pasiguri të pajustificueshme për subjektet zgjedhore, duke e lidhur të drejtën e tyre për subvencionim nga shteti me një ngjarje të së ardhmes (rezultatet e zgjedhjeve) mbi të cilat ato nuk kanë asnjë lloj kontrolli. Problemi i subjekteve zgjedhore jorelevante që formohen vetëm për të marrë subvencione shtetërore duhet të adresohet përmes ndryshimit të Nenit 87/2 me sipër dhe ndryshimeve në Ligjin për Partitë Politike (shih më poshtë), i cili lehtëson çregjistrimin e partive që nuk janë aktive. Opsioni i dytë që parashikohet me ndryshimin e Nenit 87/2 mund të përdoret nëse gjykohet se shpërndarja aktuale e subvencioneve avantazhon në mënyrë të padrejtë partitë e krijuara, siç mendojnë në fakt shumë vetë se ndodh, pavarësisht rreziqeve të përfimit të subvencioneve shtetërore nga subjekte zgjedhore jorelevante. Sugjeroj dy gjëra: që subvencionet të alokohen në fillim të fushatës, jo i gjithë fondi tu jepet, por dy të tretat, një e treta e mbetur tu shpërndahet pas zgjedhjeve duke marrë parasysh rezultatin. Duhet të jetë e qartë që partitë politike mos të marrin fonde kur nuk kanë asnjë votë. Përveç kësaj, dispozitat për çregjistrimin e partive politike, tani po i referohemi Ligjit për Partitë Politike, parashikojnë që partitë që nuk janë aktive apo adresat e të cilave nuk mund të identifikohen ose për një periudhë të gjatë, duhet të çregjistrohen për ti hequr këta subjekte jorelevante.

Tema e tretë i përket të ardhurave nga burime private. Ka dy gjëra këtu, neni 87/1 i Kodit zgjedhor, problemi këtu është (vitin e kaluar ne kemi trajtuar këtë problematikë kur po shqyrtonim formatet e standartizuara për raportimin e financimit të fushatës zgjedhore) është e nevojshme të sigurohet se përkufizimi i kontributeve ose donacioneve do të thotë që donacionet

për kandidatët konsiderohet si donacion ndaj partisë. Partia duhet të raportojë çdo gjë, është sistem liste dhe partiake dhe nuk është një sistem bazuar në kandidatë, prandaj duhet futur raportimi i këtyre donacioneve në llogari të partisë politike.

Çështja e dytë i përket ndalimit të dhuruesve të palejuar dhe ndalimit të kontratave shtetërore, përkatësisht Nenet 89 dhe 89.3 a). Aktualisht ligji parashikon se partia nuk duhet të marrë donacione nga një subjekt që ka marrë kontrata shtetërore apo lloj tjetër përfitimi si koncesionet në dy vitet e fundit. Këtu mungon rregullimi i situatës kur një donator dhuron një partie dhe më pas merr përfitimet pas zgjedhjeve. Pra, këtu bëjmë një përmbysje të dispozitës duke shtuar një pikë ku thuhet se entet që i dhurojnë një partie politike nuk mund të marrin kontrata publike, koncesione ose fonde me vlerë totale që tejkalon 10 milion lekë (përfshirë edhe si nënkontraktues të një kontrate/koncesioni publik, më disa vende këta përdoren për t'u shmatur sistemit) për 3 vjet pas dhurimit.

Tema tjetër është mbi shpenzimet dhe aktivitetet e fushatës dhe kjo përben një nga pjesët kryesore të rekomandimeve. Së pari, Neni 79, nën këtë temë do të vini re se dispozitat janë transferuar nga Ligji për Partitë Politike në Kodin Zgjedhor, sidomos dispozitat e miratuara në Majin e viti të kaluar. Së pari, dispozitat përsa i përket hapësirës së lirë për fushatë. Ka disa ndalime për materialet statike propagandistike, të cilat tashmë janë të parashikuara në Ligjin për Partitë Politike dhe ndalimi për propagandën në televizion dhe radio të cilat janë të parashikuara në Ligjin për Partitë Politike dhe propozohet të ankorohen më fort në Kodin Zgjedhor. Rreziku me këta ndalime është se subjektet zgjedhore të cilat nuk kanë përfitimet e pushtetit mund të përfundojnë me mundësi të kufizuara për fushatë prandaj këtu parashikohet më qartë se çfarë duhet të vërë në dispozicion njësia e qeverisë vendore. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që garantojnë vizibilitet publik dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Së dyti, neni 79/3 duhet të rishkruhet dhe të transferohet nga Ligji për Partitë Politike dhe është ndalimi gjatë fushatës zgjedhore, mbi përdorimin dhe afishimin e çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore në një largësi prej më pak se 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike.

Një tjetër problem përsa i përket shpenzimeve, aktualisht ka një kufi për shpenzimet e fushatës të cilat janë 10 herë më të larta se shumica e përfituar nga subvencionimi shtetëror. Ky kufi është jorelevant pasi shumë i lartë dhe ka një sugjerim këtu që të reduktohet në dy dhe jo 10 herë.

Të ndryshohet Neni 90.3 si vijon: “Shuma e shpenzimeve të bëra nga një parti politike, përfshirë kandidatët e saj, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të jetë më shumë se 2 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore. Edhe ky pragu i propozuar në dy herë është i hapur për diskutim, në fakt e diskutuam me Oerdin para takimit sot dhe kjo është një tjetër anë e efektit që do sigurojë që kostoja e zgjedhjeve nuk është e lartë. Vendosja e kufizimeve në aktivitete dhe aspekti tjetër i përcaktimit të kufirit për shpenzime janë efektive. Unë do isha dakord me Oerdin se për një vend si Shqipëria është ide e mirë që subvencionet shtetërore të jenë burimi kryesor i financimit, por nuk duhet të jetë i vetmi duke parë problemet ekonomike të vendit dhe problemet që rrjedhin nga të ardhurat nga burimet private, për specifikat e Shqipërisë do ishte e këshillueshme në fakt që financimi shtetëror të ishte dominues. Ky është një kompromis sipas të cilit burimet shtetërore duhet të jenë gjysëm ose ndoshta kufiri duhet të jetë me i ulët. Neni 84 lidhur me ndalimin e reklamave politike me pagesë në radio dhe televizion. Ky rregullim u vendos me ndryshimet e bëra në Maj të vitit të kaluar, por kishte një bazë ligjore të dobët që në fakt binte në kundërshtim me Kodin Zgjedhor dhe rekomandimi këtu është që të parashikohet në Kodin Zgjedhor. Kjo është mënyra më e mirë për të reduktuar shpenzimet e fushatës.

Çështja tjetër është dokumentimi dhe publikimi. Së pari, Neni 90, ku ka patur një rekomandim jo vetëm nga ne por edhe nga shoqëria civile, u pragu që duhet të raportohet publikisht duhet të ulet. Një rekomandim tjetër është që pragu mbi të cilin dhurimet duhet të bëhen publike të ulet nga 100,000 lekë në 50,000 lekë. Respektimi i këtij detyrimi mund të monitorohet në praktikë vetëm nëse këto dhurime duhet të bëhen në llogarinë bankare të partisë. Ka edhe një rekomandim tjetër që të shtohet neni 90/1 me titull ‘Deklarimi dhe publikimi’. Kjo ndjek punën që kemi bërë për hartimin formateve të standarizuara të raportimit të fushatës zgjedhore, e cila është në fuqi. Duhet shtuar ky parashikim në Kodin Zgjedhor për detyrimin e dorëzimit të raporteve të financimit të fushatës zgjedhore dhe së dyti për të parashikuar disa detaje se çfarë duhet të përfshijë raportimi. Kjo përfshin dhe detyrimin për ruajtjen e dokumentimin për disa kohë e me radhë.

Tema tjetër është keqpërdorimi i burimeve shtetërore një nga fushat më komplekse. Këtu kemi bërë tre rekomandime, së pari neni 81.3 efektivisht, lejon fushatën zgjedhore nga institucione publike vendore ose qendrore; kriteri që kjo kohë të llogaritet si minutazh i subjektit zgjedhor të cilit i përket titullari i institucionit është një mënyrë e komplikuar dhe e pabesueshme

për rregullimin e kësaj çështjeje. Prandaj, në vend të këtij rregullimi propozohet ndalimi i drejtpërdrejtë i një përdorimi të tillë të medias në Nenin 88. Për këtë argumentim propozohet të hiqet neni 81.3. Parashikimet e tjera përsa i përket keqpërdorimit të burimeve shtetërore janë lidhur me Nenin 88. Fillimisht, Neni 88.2 i cili aktualisht ndalon përdorimin e organeve ose enteve publike qendrore ose vendore ose të çdo enti tjetër, ku shteti zotëron kapital ose aksione dhe/ose emëron shumicën e organit mbikqyrës ose administrativ të entit, pavarësisht burimit të kapitalit apo pronësisë (këtej e tutje “ente publike”), shtova këtu që nuk mund të përdoren ose të vihen në dispozicion në asnjë moment për të mbështetur kandidatët, partitë politike apo koalicionet në zgjedhje. Së dyti, burimet njëjësore, aktualisht përdorimi i punonjësve të administratës publike brenda orarit të punës, si dhe përdorimin e detyruar dhe të organizuar të nxënësve të sistemit parauniversitar gjatë orëve të mësimit, në fushatë zgjedhore është i ndaluar. Këtu shtova edhe parashiki se përdorimi i burimeve njerëzore përfshin edhe presionin ose ofrimin e përfitimeve nëpunësve publikë ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë orarit të punës ose mësimit.

Tema tjetër është monitorimi i fushatës, në Maj të vitit të kaluar u fut si ndryshim, Sugjeroj ndryshimin e Nenit 90.2 duke transferuar në fakt parashikimet nga Ligji për Partitë Politike në Kodin Zgjedhor dhe riformuluar dispozitën e re. Gjatë punës tonë në trajnimin e audituesve vitin e kaluar, identifikua vijën shumë të paqartë ndërmjet punës së auditimit dhe monitorimit, ka mbivendosje. Propozimi është për ti dalluar, të shtohet një Nen i ri 90/2, me titull “Monitorimi i fushatës zgjedhore”, ku KQZ-ja cakton një numër të mjaftueshëm personash për të monitoruar përmbushjen nga subjektet zgjedhore të detyrimeve në lidhje me financimin e fushatës. Monitoruesit duhet të përzgjidhen nga personat me përvojë në vëzhgimin e zgjedhjeve dhe në mënyr të veçantë aktivitetet. Monitorimi kufizohet me vëzhgimin e respektimit të verifikueshëm lehtësisht të detyrimeve të subjekteve zgjedhore në lidhje me fushatën zgjedhore, duke përfshirë respektimin e ndalimeve dhe kufizimeve të formave të caktuara të fushatës dhe shpërdorimit të burimeve shtetërore dhe jo përlllogaritjen sa ishte shpenzimi, pra që nuk kërkon ekspertizë financiare dhe është e ndryshme nga auditimi. Kky ishte ndryshimi më i madh aty dhe nuk po ndalem të aspektet e tjera.

Për auditimin e pavarur e cila është tema e ardhshme.

Së pari, kjo nuk është në versionin e dokuentit që keni përpara, në 2012 paragrafi u hoq nga Kodi Zgjedhor ku parashikohej kompetenca e KQZ-së për të verifikuar raportet e auditimit. Propozoj

që parasikimi të rivendoset në Kodin Zgjedhor. KQZ të verifikojë raportet e audituesve nëse është e nevojshme dhe më e rëndësishmja, të verifikojë raportet e partive politike nëse është e nevojshme. Ky është neni 91. Pastaj Neni 92 parashikon se ekzistjnë fnde të mjaftueshme për të shpërblyer monitoruesit e fushatës zgjedhore dhe audituesit e pavarur të raporteve financiare mbi fushatën zgjedhore. Ka një rekomandim këtu që nëse është e mundur të përfshihet edhe një Premium automatik për audituesit e pavarur – p.sh. tarifa me të cilën do të paguhet është 20% ose diçka e tillë mbi mesataren e tregut (nëse dihet sa është mesatarja). Kjo për shkak të natyrës jo tërheqëse (dhe në fakt të rrezikshme) të punës nga përvoja e punës me audituesit.

Tema tjetër janë kompetencat e KQZ-së, ka dy pika kryesore këtu (neni 21), së pari të parashikohet se KQZ-ja ushtron mbikëqyrjen e financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore në përputhje me parashikimet e Pjesës VII të këtij Kodi dhe Nenit 15/2 të Ligjit për Partitë Politike.”

Pika e dytë shumë e rëndësishme është ndryshimi i listës së kompetencave ku të jetë e qartë se KQZ-ja shqyrton dhe zgjidh ankesat e subjekteve zgjedhore dhe individëve në lidhje me shkeljet e supozuara të Kodit Zgjedhor dhe ligjit për partitë politike gjatë fushatës zgjedhore dhe procesit zgjedhor. Një të shkuarën është identifikuar si problematikë edhe raportet e ODIHR gjithashtu e kanë identifikuar. Kjo nuk është një problematikë për financimin por për të gjithë procesin zgjedhor, nevojit një qasje në ankimim jo vetëm për subjektet zgjedhor. Mundet ta rishikojmë formulimin e rekomandimit nëse është më i mirë apo jo.

është një pikë tjetër që nuk është në dokument por është sugjeruar në ditët e fundit, duhet të ketë një pikë të nenit 21 ku të përcakthet se KQZ-ja miraton rregullat dhe procedurat për për mënyrën e verikimit të raporteve të partive politike dhe fushatës zgjedhore.

Tema e fundit përta i përket Kodit Zgjedhor, janë sanksionet, ka disa ndryshime që rekomandohen të bëhen lidhur me nenin 173 të Kodit Zgjedhor. Qëllimi i këtyre rekomandimeve është rritja e sanksioneve dhe dallimi ndërmjet sanksioneve për financiarët dhe shefin e financës që duhet rregulluar në nenin 173.1 dhe që gjoha të rritet deri në 200,000 lekë. Pjesa tjetër e nenit 173 është për sanksionet mbi partitë jo për financerët e partive. Qëllimi është që financiarët duhet të jenë përgjegjës, por përvoja jonë me ta është se ekziston një rrezik që të përdoren nga partitë për shkelje që nuk i kanë bërë. Të gjithë financiarët erdhën në trajnimet e organizuara nga Këshilli vitin e kaluar dhe ishin të vëmendshëm që të mos binin prë e teknikaliteteve. Rekomandohet rritja e sanksioneve që prekin partitë (kjo është ne paragrafet

173.3-7). Një shënim këtu kam hequr saksionet për donatorët të cilët dhurojnë mbi pragun e lejuar, ose donator që është i ndaluar të dhurojë. Rekomandoj që ai nen të rivendoset në vend të pikës 7 mbi shkeljen e kufirit maksimal të shpenzimeve nga një subjekt zgjedhor. Propozoj që të zëvendësohet me shkeljen e dhurimeve nga një donator në lidhje me Nenin 90 të Kodit dhe dënohet më një gjobë deri në 30 përqind të shumës së dhuruar. Kjo është një dispozitë që është në Kodin Zgjedhor aktual, e kisha hequr aksidentalisht dhe sugjeroj të mbahet. Këto janë ndryshimet në Kodin Zgjedhor.

Në ligjin për Partitë politike, rekomandohet që shumë nene të hiqen, sidomos ata të miratuara vitin e kaluar në Maj, sugjeroj të hiqen dhe shtohen në Kodin Zgjedhor me disa shtesa dhe ndryshime. P.sh të hiqen Nenet 24/1.1 dhe 24/1.2 pasi këto dispozita ekzistojnë ndërkohë në Kodin Zgjedhor. Të hiqen Nenet 24/1.3; 24/1.3 dhe 24/1.4 dhe 24/1.5.

Fusha e dytë e ndryshimit i përket subvencioneve shtetërore, ky ka qenë një rekomandim i cili trajton dispozitën lidhur me mbjtjen e aktiviteteve të zakoshme duke e kushtëzuar asistencën financiare vjetore, me paraqitjen nga partia politike të raportit të saj të fundit financiar në përputhje me rregullat e vendosura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Duke e zbutur masën nëse partia e ndreq situatën brenda 3 muajve nga afati i zakonshëm i dorëzimit, financimi nga shteti fillon në datën e marrjes së raportit.

Lidhur me të ardhurat nga burimet private, të shtohet një dispozitë në Nenin 20 me të njëjtin formulim si Neni i ndryshuar 89.3 a) i Kodit Zgjedhor dhe shtesa e rekomanduar në Nenin 89.3 në lidhje me dhurimet nga përfitues të mëparshëm apo të ardhshëm të kontratave, koncesioneve ose fondeve publike.

Për raportimin dhe publikimin, ka një rekoandim të rëndësishëm këtu, neni 23. Aktualisht të gjitha partitë politike duhet të dorëzojnë raportet vjetore dhe kjo është një barrë për KQZ-në dhe për audituesit, Shumë nga këto parti nuk eksiztojnë më dhe është ide e mirë për të vendosur një prag. Neni 23.1 ndryshohet duke parashikuar se Partitë politike që kanë marrë financim nga shteti për veprimtaritë e tyre vjetore ose për një fushatë zgjedhore gjatë dy vjetëve të fundit duhet të dorëzojnë deri në datën 31 mars të çdo viti një raport financiar për vitin e mëparshëm në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Partitë që nuk kanë marrë financim nga shteti nuk e kanë këtë detyrim.

Lidhur me kompetencat e KQZ-së Neni 15.2 të parashikojë se KQZ-ja përgatit dhe miraton rregullat për monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin financiar të partive politike, duke

përfshirë modelet e standardizuara për raportimin financiar vjetor dhe për raportet e audituesve të pavarur për raportet financiare vjetore. Të shtohet Neni 15/2 i), ku të parashikohet kompetenca e KQZ-së për të marrë shqyrtuar ankesat në lidhje me shkeljet e supozuara të rregullave të financimit të partive.

Mbi auditimin e pavarur, rekomandim i ngjashëm me Kodin Zgjedhor ku sigurohet një dispozitë e ngjashme me Kodin Zgjedhor, buxhet të mjeftueshëm dhe mundësia e shpërblimit. Një tjetër dispozitë ka të bëjë me çregjistrimin e partive politike, neni 26 i Ligjit për Partitë Politike. Shtohet lista e shkaqeve të çregjistrimit të një parti politike, kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ose audituesit e pavarur të raporteve financiare vjetore ose raportet financiare të fushatave zgjedhore konfirmojnë se partia politike nuk e ka zyrën ose nuk është e pranishme në adresën e saj zyrtare.

Së fundmi sanksionet: Në nenet 23/4 ka disa sugjerime për rritjen e sanksioneve, nga marrja e fondeve nga donatorë të ndaluar duke rritur gjobat që do ti parandalojë për të marrë këto donacione.

Shpresoj që isha i qartë dhe jam i hapur për diskutim.

Bledar Çuçi- Faleminderit Z. Rid, për këtë paraqitje të detajuar dhe për propozimet konkrete për dy ligjet kryesore, që lidhen me financimin e partive politike dhe me fushatën zgjedhore, pra në Kodin Zgjedhor dhe në ligjin për partitë politike. Mendoj se propozimet plotësojnë, në masën më të madhe të madhe të tyre, rekomandimet që ka bërë OSBE-ODIHR për tri zgjedhjet e fundit në Shqipëri, përkatësisht për rekomandimin vitit 2011 në zgjedhjet lokale, rekomandimi 11; për rekomandimin për zgjedhjet vitit 2013, rekomandimi 20, dhe për zgjedhjet e vitit 2015, rekomandimet 5 dhe 18, të cilat duhen shoqëruar edhe me propozime për ndryshime ligjore. Pjesa tjetër është rregullatore apo edhe pjesë e praktikës apo e zbatimit të ligjit.

Tani le të hapim diskutimet jo vetëm duke u kufizuar te propozimet e zotit Rid, por, sigurisht, dua që fillimisht, kush ka pyetje për zotin Rid, të konsumojmë pyetjet dhe përgjigjet, më pas kush ka propozime të tjera, sidomos edhe nga ekspertë të tjerë që ndodhen në sallë. Kështu që tryeza është e hapur për diskutim.

Urdhëroni, zoti Mediu!

Fatmir Mediu – Faleminderit, zoti Çuçi!

Dua të falënderoj Këshillin e Europës për ndihmën dhe në mënyrë të veçantë zotin Rid, për shpjegimet dhe propozimet e hollësishme, bazuar në rekomandimet e OSBE-ODIHR-it! Që

në fillim dua të theksoj se çështja e financimit të fushatës zgjedhore në Shqipëri nuk ka të bëjë me teknikalitetet, por qartësisht ka të bëjë me një influencë të zgjeruar të grupeve të interesit dhe të krimit të organizuar për të ndikuar në procesin zgjedhor dhe për të manipuluar procesin zgjedhor.

Së pari, ndoshta do të ishte e nevojshme që të kishim të paktën një model, i cili do të minimizonte këto efekte të ndikimit të parave jo të ligjshme në procesin zgjedhor.

Së dyti, aktualisht ajo që konstatoj në Kodin Zgjedhor, në ligjin “Për partitë politike”, por edhe nga propozimet tuaja është se sanksionet nuk ia vendosim as subjektit dhe as kandidatit, por përgjithësisht ua veshim personave të tjerë, të cilët janë pjesë e procesit të shkeljes së ligjit apo të manipulimit të procesit, por nuk ndikohen drejtpërdrejtë prej saj. Dua të them se sanksionet janë shumë të buta. Për shembull, në qoftë se kapet dikush duke blerë vota, siç ishte rasti i zgjedhjeve të fundit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në Vorë e ka dhënë “Top Channel”, sekretari i Partisë Socialiste... *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në qoftë se e do, mund ta them. Thuaje ti për vitin 2005, unë po e them për zgjedhjet e fundit

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk flas siç do ti, ti fol si të duash. Konkretisht po e them, e ke me video në “Top Channel”, po pra sekretari i Partisë Socialiste.

Në rastin konkret, kur manipulohen zgjedhjet, nuk ndëshkohet as kandidati dhe as subjekti. Deputeti fiton, manipulon zgjedhjet, bëhet deputet, partia fiton. Sipas studimit të Bashkimit Europian, 20% e votave janë të manipuluar. Asgjë nuk ndodh, por ka vetëm sanksione financiare, penalizime për atë që ka arritur të futet në proces për të blerë. Ky është shqetësimi që kemi ne.

Shqetësimi i OSBE-ODIHR-i është blerja masive e votave dhe ndërhyrjet e grupeve të paligjshme në proces. Pra, a do të vijmë në një pikë, ku ne të fillojmë të kuptojmë, se ai që duhet të paguajë është kandidati ose subjekti politik, jo më me gjoba financiare, sepse ato e tejkalojnë, por me penalitet zgjedhor? Ne jemi në një garë zgjedhore dhe në një garë zgjedhore, kur t’i bën një veprim të paligjshëm, pa dyshim që duhet të jetë dhe sanksioni i skualifikimit të kandidatit që e bën këtë manipulim, i subjektit, sepse përndryshe ne do të kemi viktima tërësisht terciare, që

nuk kanë asnjë ndikim në rezultat, dhe më pas do të futen në procese që zgjasin pafundësisht dhe asnjëherë nuk e ndryshojmë dot realitetin që kemi.

Një tjetër çështje, që mendoj se është për t'u vlerësuar, është çështja e financimit të fushatave zgjedhore. Ne duhet të vijmë në një pikë, që shteti duhet të marrë përsipër financimin e fushatave zgjedhore, pa dyshim në mënyrë modeste dhe të shmangim tërësisht financimin privat. Ju me Kod kemi parashikuar rastet kur nuk është i ligjshëm financimi privat, kur kanë marrë tenderë publik e të tjerë. Po jua them me raste konkrete, që nuk ka asnjë ndëshkim në raport me këtë çështje, as subjekti që ka financuar dhe as subjekti që ka përfituar, pra as partitë politike dhe as bizneset. Gjithmonë kemi hapin e parë të korrupsionit politik dhe qeverisës në fillimin e procesit zgjedhor nëpërmjet financimeve dhe më tej vazhdon me ndikimin që ka në procesin e vendimmarrjes qeverisja që ka fituar për shkak të mbështetjes financiare që ka gëzuar dhe që do të gëzojë për zgjedhjet që do të vijnë.

Po ashtu dua të ngre një çështje tjetër, e cila ka të bëjë me pabarazinë në zgjedhje. Ligji “Për partitë politike”, por dhe Kodi Zgjedhor parashikojë se financimi, pothuajse në pjesën më të madhe, iu shkon subjekteve ekzistuese, sipas përqindjes së votave që ata kanë marrë. Atëherë, më thoni se çfarë gare zgjedhore është kjo, kur subjektet politike hyjnë në garë me njëra-tjetrën me një diferencë shumë të madhe, qoftë dhe nga pikëpamja financiare? Kjo në gjykimin tim është e padrejtë dhe duhet parë. Në qoftë se vijmë tek ideja që ne duhet të rrisim më shumë financimin publik dhe përgjegjësitë e shtetit për financimin publik, dhe të minimizojmë ose të eliminojmë financimin privat, mendoj se do të ishte një rrugë (duke shtuar sanksionet e penaltitetet, në rast se provohet e kundërta), që mund të shmangë një pjesë të konsiderueshme të manipulimit të procesit zgjedhor.

Kurse në lidhje me çështjen e materialeve propagandistike e të tjerë, një Zot e di si kthehet Shqipëria në procesin zgjedhor, sepse nuk di të ketë ndonjë vend tjetër si vendi ynë. Ne kemi qenë në të gjitha vendet europiane, por edhe në vendet ballkanike, ku janë zhvilluar proceset zgjedhore, domethënë, në Shqipëri ka vend e pavend flamuj, postera e të tjerë. Pra, një lloj shkarravine për vendin, që është krejt e papranueshme. Ajo që thoni se bashkitë janë të detyruara të përcaktojnë vendet, ka qenë prej kohësh, asnjëherë nuk është respektuar, secili ka vepruar sipas interesit politik të subjektit që përfaqëson, nuk ka as barazi në garë, nuk ka as barazi në shfaqjen publike dhe mundësi për të garantuar si kandidatët edhe subjekte politike që të

kenë mundësi të ndikojnë në opinion publik nëpërmjet gjykimit dhe vlerës politike që kanë dhe jo nëpërmjet pazareve.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Mediu!

Urdhëroni, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj - Faleminderit!

M'i dogji të gjitha tezat zoti Mediu, por kjo e ka edhe një të mirë, sepse tregon faktin se ka një interes të përbashkët, sigurisht për të gjithë sferën politike, por, siç duket, më tepër për atë që sot është në opozitë, qoftë edhe për gjurmët e zgjedhjeve të fundit që kanë kaluar.

Unë do të mundohem të bëj një parashtrësë dhe në fund do të bëj një kërkesë për ekspertin, si do ta shikonte ai këtë lloj modeli që do të ofroja, që në fakt, e tha pak zoti Mediu. Sa herë që bëhet fjalë për financim të partive politike, as më shumë dhe as më pak, bëhet fjalë për garë zgjedhore, pjesa tjetër është thjesht elegancë e demokracisë. Jashtë fushatave zgjedhore, veprimtaria politike e partive politike është pothuajse irrilevante. Sa herë që bëhet fjalë për fushatë zgjedhore, jemi në një garë, e cila më tepër se sa garë ideshë, besomëni për këtë, është garë për akumulim parash. Aq e fortë është kjo metamorfozë dhe aq shpejt ndodh, sa çfarëdolloj skrupulli bie, madje shkon deri atje sa humbet çfarëdolloj sistemi vlerash politike.

Historia e identifikimit të shpenzimeve, e destinacionit të tyre është akoma më e vështirë për t'u nxjerrë në pah. Nuk shiten ide, siç duhet të ndodhë normalisht në shoqëri të qytetëruara, por blihen hapësira publike me flamuj, me pankarta, tha zoti Mediu, madje shkon deri atje sa dhunohen njerëzit, dhunohet publiku, blihet hapësira mediatike e të gjitha niveleve. Kur kjo metamorfozë ndodh në situata politike të fushatave zgjedhore, si blerja e hapësirës publike, blerja e hapësirës mediatike, pse të mos blihen dhe njerëzit?! Ndodh. E gjithë kjo histori, që ndodh në fushata zgjedhore, nuk bën gjë tjetër, veçse shndërron thelbin e sistemit të demokracisë, të pluralizmit. Jo vetëm kaq, sepse nuk përfundon vetëm këtu, kaq e fortë është kjo metamorfozë që ndodh gjatë fushave zgjedhore, sa virusi i bjerrjes së vlerave morale, i humbjes së ideologjisë politike mbartet dhe shndërrohet në ideologji të pushtetit. Pushteti blihet me para, pse të mos mbahet me para. Nga një shndërrim i brishtë, i vogël i sistemit të pluralizmit gjatë fushatës zgjedhore njëmuajore, 45-ditore, 3-mujore, 6-mujore, quajeni sa të doni, ndodh një shndërrim i sistemit të demokracisë që mund të zgjasë një 4-vjeçar e në vazhdim.

Në fakt, pyetja më e madhe që duhet të vijë në një moment që t'i japim zgjidhje është: çfarë modeli duhet të ketë ky vend, së paku për sektorin e financimit të partive politike? Për të

mos u lëkundur në fantazi politike dhe demokratike pse të mos i bëjmë një referencë asaj çfarë Kushtetuta e Shqipërisë thotë? Tek e fundit çfarë duhet të sjellë dhe çfarë shërbimi duhet të japë sistemi i pluralizmit politik, i alternativave partiake?

Së pari, duhet të garantojë barazinë e votës, aktive dhe pasive, një e drejtë kushtetuese.

Së dyti, duhet të garantojë të drejtën e informimit.

Së treti, duhet të garantojë lirinë e shprehjes.

Të gjitha këto janë liri dhe të drejta të parashikuara në Kushtetutë, të cilat kërkojnë një ndërhyrje të shtetit. Madje, jo vetëm kaq, por Kushtetuta shqiptare me një togfjalësh në nenin 9 përcakton: “Burimet dhe shpenzimet e partive politike duhet të jenë publike”. Pra, na mëson se ky është standardi dhe kriteri që duhet të përcaktojë, nga i cili duhet të ekstrahohet edhe modeli i financimit të partive politike. Besoj se nga kjo gjë ka dalë edhe pyetja që dua të bëj: pse të mos adoptojmë një sistem të financimit të partive politike, që në analizë të fundit është financim i sistemit të demokracisë, e para, nga buxheti i shtetit, dhe, e dyta, në kushte barazie.

Kam edhe një parantezë e të fundit, para se ta mbyll fjalën time. Nuk ka mjet më të mirë, kjo është përvojë personale, për të ulur shpenzimet e pamasa, kryesisht ato kulte, në fushata zgjedhore se sa situata e pabarazisë. Siç e thashë më parë, ajo çfarë ndodh në fushata zgjedhore nuk është garë idesh, por është garë shpenzimesh. Shterpësia e ideve politike apo e ideve programatore i shndërrojnë partitë politike në një garë pa sens, se kush shpenzon më shumë, sepse duket se në këtë mënyrë bëjnë vota, dhe, në fakt, ta themi hapur, i bëjnë votat. Ndërkohë, nëse vendoset paraprakisht sensi i barazisë së shpenzimeve edhe burimi i tyre të jetë publik do të sillte:

Së pari, lehtësi në kontrollin e tyre.

Së dyti, qartësi në represionin ndaj përdorimit të fondeve okulte.

Së treti, dhe që është më e rëndësishme, fakti që ata, të cilët kanë vendosur ta kalojnë jetën e tyre duke u marrë me politikë, në fushatën zgjedhore të vrasin mendjen për të bërë luftë idesh politike dhe jo aftësish për të akumuluar fonde. Pyetja është kjo: pse nuk e bashkëndajmë këtë lloj ndjesie, që vjen nga përvoja shqiptare, por edhe nga parashikimet kushtetuese? Financim i qartë dhe i plotë i....

(Ndërhyrje në gjuhën angleze.)

Bledar Çuçi - Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë do të doja ta falënderoja ekspertin e Këshillit të Europës, zotin Rid, në lidhje me çështjet e parashtruara! Në fakt, një nga nevojat që ne kemi pasur ka qenë një propozim konkret i dispozitave që duhet të prekim ne, si Komisioni i Reformës Zgjedhore, për të adresuar një çështje shumë të rëndësishme, siç është financimi i aktiviteteve politike gjatë fushatave zgjedhore, por edhe financimi i partive politike, transparenca, monitorimi dhe përgjegjësidhënia. Nga materiali që na keni vënë në dispozicion, të cilin unë e lexova, arrita të kuptoj se do të kemi nevojë, nëse do të biem dakord, që t'i marrim këto sugjerime dhe të ndryshojmë apo të propozojmë ndryshime në Kodin Penal, sepse unë shikoj ashpërsimin e disa dënimeve dhe shtesën e disa veprave të reja penale, siç është fakti i mashtrimeve që mund të ndodhin në raportet financiare të partive politike për sa i takon financimeve të marra.

Sigurisht ne, si Komisioni i Reformës Zgjedhore, nuk e kemi kompetencën që t'i kryejmë këto ndryshime në Kodin Penal, sepse duhet të sugjerojmë vetëm pjesën që i takon fushatës zgjedhore, pra gjithçka që ka të bëjë me sistemin zgjedhor. Sigurisht, ne do të rekomandojmë, por a do të kemi një material më vete veçmas këtij, i cili mund të na listojë ato nevoja për ndryshim edhe në Kodin Penal, nëse do të miratojmë këto sugjerime që na janë bërë për sa i takon Kodit Zgjedhor dhe ligjit “Për partitë politike”? E them këtë, sepse unë mendoj se ky komision është i pari dhe i fundit që po bën një punë rrënjësore për t'i dhënë më në fund një arkitekturë ligjore Shqipërisë për sistemin zgjedhor, i cili mund të funksionojë si një i tërë, nga e para deri tek e fundit, që të mos ngrihemi më në mbledhje, pasi të mbarojmë këtë punë, dhe të themi se nuk është ndryshuar Kodi Penal apo kemi nevojë për një ndërhyrje në një ligj tjetër. Pra, e gjithë ideja është që të kemi një kuadër të plotë të të gjitha veprimeve që do të ndërmarrim, në mënyrë që kjo histori të mbarojë këtu, në këtë komision dhe Shqipëria të ketë më në fund kuadrin e saj.

Meqenëse e mora fjalën dua të bëj vetëm dy komente. Si pasojë e marrëveshjes politike të datës 18 maj, ne kemi bërë ashpërsimin e dënimeve, por kemi shtuar vepra penale për proceset zgjedhore. Më vjen mirë të them që si pasojë e atyre ndryshimeve ne kemi pasur pa diskutim një frenim të fenomenit të shitblerjes së votës.

Unë, personalisht, kam bërë kallëzime penale në zonën time për faktet që kam konstatuar. Duke dëgjuar kolegët këtu ideja se zgjedhjet deri më sot kanë qenë një garë fuqie ekonomike dhe jo një garë idesh, më vjen keq ta them, por ky është tërësisht një perceptim, sepse nëse nuk do të

ishite i tillë, kolegët do të flisnin me fakte numrash, raportesh, kallëzimesh që janë kryer. A kanë shkuar deri në fund këto kallëzime? A kanë dalë përgjegjësit para përgjegjësive ligjore? Unë kam bërë vetë dy kallëzime, të cilat janë pushuar, por nuk e di se çfarë kanë bërë kolegët.

Unë nuk e perceptoj dot kurrë fushatën zgjedhore si një garë ekonomike, përveçse si një garë idesh dhe komunikimi direkt me njerëzit.

Kështu, unë do t'u rekomandoja të gjithë kolegëve që për efekt të nonsensit, të mirëkuptimit dhe vullnetit që kemi të gjithë për t'i dhënë Shqipërisë një sistem real zgjedhor, transparent, me garancitë që duhen, atëherë t'i lemë perceptimet dhe të flasim me fakte, sepse kështu do ta ndihmojmë edhe më shumë punën e këtij komisioni.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zonja Bushka!

Problematikat që ne kemi për diskutim sigurisht që vijnë nga rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Ne do të kemi nga një tryezë të veçantë për secilën, sidomos për problematikën e fundit që ngritet ju, shitblerjen e votës, një nga çështjet më të rënda të zgjedhjeve, që rekomandimi nr. 13 ose 14, ka kaluar në nr. 2. Ky është problem real, përfshirë edhe inpunitetin, që thatë ju. Sot ka kallëzime, por nuk ka dënime. Kjo është çështje tjetër, që lidhet me faktin se përveç parasë së ligjshme në një fushatë, janë edhe paratë jo të ligjshme dhe kriminale të fushatës. Këtë problem e ngriti edhe zoti Mediu, edhe zoti Alibeaj.

Për të mos u zgjatur, sepse do të jetë një temë tjetër dhe, pa pasur nevojë të fshihemi pas gishtit për atë problem ...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Jo, të gjithë ne, askush nuk duhet të ...

Është çështje ...

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Po, unë jam dakord. Këtë doja të thosha.

Një qasje, besoj solide tashmë nga ana jonë, është që reforma nuk do të jetë vetëm e Kodit Zgjedhor dhe në rastin konkret vetëm me ligjin e partive politike. Shumica e problemeve zgjedhore po zhvillohen jashtë kornizës që rregullon dhe disiplinon Kodi Zgjedhor. Ligji i partive politike është një prej tyre, por ka edhe ligje të tjera që, duke ndërhyrë, do të na vijnë në ndihmë të forcojmë perimetrin që mbron procesin zgjedhor, si një proces demokratik dhe delikat. Ndoshta duhet të ndërhyjmë në ligjin “Për Policinë e Shtetit” apo në legjislacione që rregullojnë

sjelljen e aktorëve të tretë, përfshirë korporatat shtetërore, por një nga instrumentet më të rëndësishme që kemi ne, siç e thatë edhe ju, është Kodi Penal. Pra, duhet t'i shikojmë në mënyrë harmonike edhe në Kodin Penal, sepse ndërhyrja e vitit 2017 ishte e momentit të fundit, e shpejtë dhe jo e mjaftueshme.

Një nga instrumentet që ne kemi futur, i cili nuk ka lidhje *cross-cut*, por është për shitblerjen e votës, e kthym në një vepër korrupsioni, e për rrjedhojë, në të ardhmen, nuk e dimë se kur, do të jetë objekt i punës së SPAKU-t. Pra, ndërhyrja do të jetë më e gjerë. E rëndësishme është që ne, si anëtarë të komisionit, të kemi dilijencë dhe të jemi me mendje të hapur për të gjetur të gjitha aspektet ku duhet të ndërhyjmë me propozime në bashkëpunim me ekspertët.

Do t'ia kaloj fjalën zotit Rid për komente.

Quentin Reed- Thjesht një koment për sanksionet penale. Nuk di çfarë të rekomandoj më pasi dispozitat janë aty në Kodin Penal, Kjo ndoshta nuk është çështje që i përket rregullimit të financimit të partive politike. Nuk është fokusi ynë, është shumë e vështirë për ta zgjidhur këtë problematikë nëpërmjet kësaj pjesë të rregullimit të financimit. Ekziston në Kodin Penal, dhe kemi rekomanduar se veprat për shitblerje vote të jenë kompetencë e prokurorisë dhe gjykatës së posaçme. Më shumë se rregullimet në Ligjin për Partitë Politike, janë sanksionet në Kodin Zgjedhor për shkejlje të rregullimeve të financimit, për më tej nëse gjatë një procesi mbikqyrjeje identifikohet ndonjë sjellje kriminale, ekzistojnë tashmë dispozitat në Kodin Penal për vepra penale që prekin zgjedhjet dhe thjesht duhet të përdoren, Më e rëndësishme është si arrihet aty, roli i ankesave dhe KQZ në identifikim e shkejljeve dhe referimin në prokurori.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Rid!

Zoti Krasniqi, fjala për ju.

Krasniqi - Faleminderit!

Në fakt, edhe unë e quaj pozitiv materialin, por më lejoni të jem i sinqertë, pasi nuk zgjidh asgjë. Materiali që shikoj në tavolinë nuk zgjidh asnjë nga problemet kryesore që kemi me financimin zgjedhor. Këtu janë një sërë propozimesh, të cilat, kam përshtypjen se kanë probleme edhe për shkak të përkthimit, por edhe për shkak të shembujve të modeleve të tjera që nuk përputhen me ne.

Gjithsesi, dua të ndalem në disa pika në material, që konsideroj se duhen rishikuar.

Së pari, rekomandimi nr. 2 i ODIHR-it për burimet e financimit nga grupe të ndryshme, që quhen grupe kriminale apo burime të papastra, sipas legjislacionit plotësues sekuestrohet çdo

burim i tillë në bazë të ligjit. Në rastin e fushatave elektorale dhe të partive politike nuk kemi akt të tillë, por kemi thirrje për vullnet të kandidatëve për të refuzuar paratë që vijnë nga individë me rekorde kriminale, siç thuhet në rekomandimin e ODIHR-it. Ne e dimë që fjalët “vullnet për të refuzuar para” nuk janë në gjuhën shqipe, nuk është funksionale, dhe ky ka qenë problem i fushatave të kaluara.

Së dyti, disa prej masave, kur bëhet hierarkia e masave, bazohen te masat që jepen ndaj financierit të partisë, ndaj zyrtarit të partisë dhe ndaj zyrtarit që parashikon statusi. Nuk e di sa është në dijeni eksperti, por 100% e partive në Shqipëri nuk kanë depozituar status të ri në Gjykatën e Tiranës. Rreth 97% e partive nuk kanë shëf financiar dhe kufizimi që do të çregjistrohen kur nuk kanë seli penalizon shumicën e partive politike në Shqipëri, sepse ligji për partitë politike e parashikon kur jepet seli nga shteti dhe, nëse një parti nuk merr seli nga shteti, nuk do të marrë mjedise me qira në dispozicion për 4 vjet. Ne ia lëmë në dorë një eksperti auditit të pavarur për të vendosur regjistrimin apo jo të partive politike me disa dispozita të propozuara. Mendoj se kjo është penguese dhe kufizuese për konkurrencën, por uroj të shikohet.

Së dyti, edhe propozimi i të gjithë paketës, e cila u quajt risi, që mund të jetë nga një këndvështrim, është krijimi i një strukture monitoruese nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Nuk besoj se Komisioni i Zgjedhjeve ka potencial dhe besueshmëri për ta kryer këtë funksion. E ka pasur këtë të drejtë, ka të gjitha strukturat e KZAZ-së, struktura të tjera, informacion nga shoqëria civile, nga subjekte elektorale dhe mekanizma për të marrë një vendim, por nuk e ka bërë për shkak të gjërave që ne i dimë, dhe këtë ia marrim shoqërisë civile, ia kalojmë KQZ-së, që do të miratojë përfaqësues partiak për të bërë verifikimin e fakteve, siç ka ndodhur me bordin e monitorimit të medias. Nuk e shikoj produktive në realitetin shqiptar edhe për natyrën se si funksionon KQZ-ja, se si është e kompozuar.

Për sa u përket burimeve të tjera të financimit, eksperti nuk e përmend çështjen e kuotës së anëtarësisë. Ne duam të dimë çfarë ndodh me kuotën, sepse një nga dy partitë kryesore ka deklaruar zero pagesë nga kuota për 2 vjet kalendarik, ndërsa tjetra ka deklaruar mbi 200 mijë euro. Duam të dimë nëse është real deklarimi zero që ka njëra parti, sepse pas statusit të partive ndalohet diçka e tillë, dhe euro janë deklarim real nëse 200 mijë eurot e partisë tjetër, apo është, deri diku, përdorimi i parave të justifikuara përmes kuotës së anëtarësisë, sepse këtu kemi pikën e financimit nga jashtë dhe shtetasit shqiptarë, që ndodhen jashtë shtetit, i konsiderojmë si burime të mundshme financimi dhe kontributi, por praktikisht nuk kemi kontroll për një numër

biznesesh jashtë shtetit, që në emër të tyre deklarojmë burime financimi në Shqipëri, sidomos për parti që financohen nga jashtë, ose media që blihen apo merren me qira në fushata elektorale. Në Shqipëri kemi raste konkrete.

Për sa u përket elementeve të tjera, ka disa që hapin debat. Pse duhet të presim 60 ditë pasi mbyllet procesi zgjedhor? Ju e keni parasysh që procesi zgjedhor mbyllet pas ankimimeve. Realisht ndodh që 4 muaj pas zgjedhjeve marrim raportet e para të financimit. Partitë kanë struktura dhe mund të deklarojnë burimet e financimit të fushatës elektorale 1 javë pas fushatës elektorale. Pse duhet të presim 6 muaj? 6 muaj janë tërësisht fiktiv, është larguar vëmendja e të tjera. Ne duhet t'i japim të drejtë dhe detyrim Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që, kur ka një indicie publike, pavarësisht se ka mbaruar fushata elektorale dhe periudha e deklarimit dhe verifikimit, të hapë hetim për burimet e financimit. Vetëm në legjislaturën e kaluar kemi pasur 3 raste kur deputetët, në konflikt partiak, kanë deklaruar se kanë paguar shifra marramendëse në fushatë elektorale, por nuk është marrë parasysh, sepse nuk është bërë brenda periudhës 60-ditore të monitorimit. Bëhet fjalë për shifra deri në 4 milionë euro, që është e paimagjinueshme për një konkurrencë reale.

Për sa i përket garës konkurruese, lirisë së konkurrimit dhe fushatës, unë nuk u qaj hallin partive të mëdha se nuk kanë para, por partitë e mëdha marrin paratë e të gjithë shoqërisë dhe përmes tyre kufizojmë të gjitha shanset e konkurrimit të kandidatëve të pavarur dhe prurjeve të reja politike. Duhet të gjejmë ndonjë mekanizëm, siç ka ndonjë vend tjetër, që, për shembull, kur një kandidat i pavarur del në Bashkinë e Tiranës ose në ndonjë bashki tjetër dhe konkurren, mirë që nuk i japim përkrahje përpara, sepse ka logjikë, por në varësi të numrit të votave, duhet t'i ofrojmë përkrahje pas zgjedhjeve, që një frymë e re, një individ që ka një vullnet politik dhe votohet, duhet të shpërblehet për këtë gjë dhe jo të penalizohet siç ndodh aktualisht me legjislacionin dhe siç ky dokument nuk e ofron këtë lloj garancie. Në lidhje me të drejtën e ankimimit, sidomos të marrjes së informacionit, ne kemi një problem konkret: shoqëria civile ka nisur një proces gjyqësor ndaj partive politike në lidhje me burimet e financimit dhe disa herë gjykata na ka thënë se ju nuk jeni subjekte që mund të kërkonin këtë gjë, sepse duhet ta kërkojnë vetëm subjektet konkurruese. Kjo nuk ka sens dhe ne duhet të kemi të drejtat tona si shtetas shqiptarë dhe si objekte indirekte të monitorimit, por ama të zbatojmë nenin 9 të Kushtetutës, që partitë politike t'i kenë përherë publike burimet e tyre të financimit. Mendoj se kërkohet një dispozitë e qartë që, kushdo që mendon se ka një të dhënë komprometuese, duhet të ketë

mundësi ta adresojë dhe duhet të marrë përgjigje për këtë gjë nga institucionet përkatëse, gjë që nuk ofrohet në kushtet aktuale. Pastaj ka disa elemente të tjera, si për shembull: ne flasim për burimet e përdorimit shtetëror, por nuk kemi të parashikuar çfarë ndodh me zyrtarin, i cili kapet në flagrancë, në kundërshtim me ligjin që ka përdorur mjediset shtetërore, paratë shtetërore, apo buxhetin e shtetit. Pra, duhet të ketë një harmonizim të të gjithë legjisllacionit, sepse ne kemi thënë që kur një individ ka bërë një krim para 20 apo 30 vjetësh apo ka pastruar para në Gjermani apo vende të tjera, ne e largojmë nga parlamenti dhe nga jeta politike. Në Shqipëri, kur një individ akuzohet se ka bërë shumëfishin e tij, për shembull, drejtues të lartë, maksimumi, sipas draftit, penalizojmë shefin e tij të financës, gjë që mendoj se është një paradoks në hierarkinë e strukturës.

Ka disa elemente teknike që unë do të doja t'i shqyrtonim në vijim të kësaj tryeze. Për shembull, ne flasim për medien, por në zgjedhjet e kaluara pati blerje të aksesit të internetit për Shqipërinë për rreth 24 orë, që do të thotë se çdo rrjet si, *google.com*, *yahoo.com* apo *hotmail*, u ble nga një parti politike dhe sa herë që ju klikonit në hapësirën e territorit të Shqipërisë dilte sigla e partisë. Në mënyrë automatike kjo nuk figuron askund, sepse u quajt diçka e pambuluar nga ligji.

Çfarë kuptimi ka të rrimë me telekomandë në dorë nëse e ka dhënë TVSH-ja, kur praktikisht shumica nuk e shohin TVSH-në? Ndërkohë ne kemi blerje qoftë të medias në Shkodër, që ndodh çdo zgjedhje tre muajt fundit të fushatës, qoftë dhe të hapësirave të internetit, siç është rasti konkret.

Këto janë disa nga çështjet teknike, unë kam bërë një listë të gjatë, por nuk dua të ndalem, kështu që, në shenjë korrekte për punën e bërë, do t'ia kaloj fjalën ekspertit.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Krasniqi!

Sigurisht, me vëzhgimin e hollësishëm të bërë nga ju, ka edhe çështje që dalin përtej tryezës së sotme, që është e fokusuar strikt te financimi i partive dhe fushat. Disa nga ato vërejtje, që ju bëtë edhe personalisht, i përkrah, por do t'ju ftoja që të kishit një kontribut konkret në komision dhe për të gjitha çështjet që ju ngritët jeni i mirëpritur të na sillni propozime konkrete për ndryshime rregullatore, qofshin këto ligjore, akte nënligjore apo mënyrë tjetër rregullimi, si ta mendoni ju, që t'i diskutojmë përpara se të dalim me një produkt final, siç e thashë në fillim të takimit.

Ndoshta zoti Rid ka një koment në lidhje me komentet që bëri zoti Krasniqi.

Quentin Reed– lidhur me regjistrimin që do të ndikojë në mënyrë jo të drejtë mbi partitë e vogla që nuk kanë adresë, a është e mundur të regjistrohesh pa adresë, nuk mendoj kështu, nuk pres që partitë të kenë zyra, por duhet të kenë një vend të identifikueshëm. Për rolin e KQZ-së, ajo është autoriteti mbikqyrës tashmë dhe po bëhet shumë punë për të ndihmuar KQZ-në për të përmirësuar aktivitetin në këtë drejtim. Nuk jam i sigurtë çfarë sugjeroni si alternativë, shqetësimet tuaja nëse janë të duhurit ose jo për të qënë institucioni përgjegjës mbikqyrës, çdo organ tjetër në Shqipëri do të haste të njëjtat sfida. Mbi burimet shtetërore, është një pikë shumë e mirë në fakt që nuk ka sanksione të qarta për shkelje që ndodhin, do ta konsiderojmë këtë rekomandim. Një hapësirë interneti është gjithashtu një pikë e mirë, është një fushë e re e rregullimit në mbarë botën, por mendoj është e gabuar të themi përse po i kufizojmë reklamën në Televizion dhe radio pasi aty ishte pjesa më e madhe e shpenzimeve më parë. Ndalimi i tyre do ta ulte shpenzimin shumë pavarësisht përdorimit në internet apo jo.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Rid!

Zoti Madhi, fjala për ju.

Arjan Madhi – Paraprakisht do t'ju them që do të ruaj strukturën e çështjeve që janë sot për diskutim në këtë tryezë, por edhe do të vlerësoja materialin, i cili është jo shumë serioz edhe në nivelin jashtëzakonisht të lartë teknik. Unë besoj se materiale të tilla mund të garantojnë efektivitetin e plotë të punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore, por kryesisht të grupit të ekspertëve teknikë, që kanë një barrë dhe një përgjegjësi mjaft të madhe në punën e këtij komisioni. Unë kam bindjen maksimale se do të respektohen procedurat për të arritur këtë efektivitet. Nëse Komisioni për Reformën Zgjedhore i përbërë nga deputetë vendimmarrës do të mund të dëgjonte të gjitha propozimet e aktorëve vendas dhe të huaj dhe nëpërmjet një pune të kujdesshme të ekspertëve të komisionit, do të katalogoheshin të gjitha çështjet sipas subjekteve propozuese dhe fushave që propozojnë, atëherë deputetët do ta kishin të thjeshtë nëpërmjet një relacioni të thjeshtë shoqërues të materialit që të fillonin të diskutonin dhe të merrnin vendime politike, se deri tani kam kuptuar që po konsumohet një kohë dhe nuk bëhet efektive, pavarësisht se kam shumë konsideratë për këtë material të paraqitur këtu. Pasi deputetët të marrin vendimin e tyre politik dhe të certifikojnë çështje nga të cilat rrjedhin shumë gjëra të tjera (amendamente), atëherë jemi në terrenin e duhur. Unë si ekspert do të vlerësoja shumë ndihmën e KE-së, të eksperteve të OSBE/ODIHR-it, pasi ne kemi përcaktuar qëndrimin dhe nuk punojmë në boshllëk, por thjesht draftojmë materiale, shkojmë si grup ekspertësh përpara grupit të

deputetëve njëllor si në komisionet parlamentare. Ne relatojmë propozimin e ardhur, pasi janë analizuar të gjitha propozimet brenda një fushe, i cili ka propozimet dhe rekomandimet tona, por kurrsesi të ndara nga rekomandimet dhe asistenca për të cilin kemi shumë nevojë. Këtë nuk e them për modesti, por bazuar në një vlerësim shumë të sinqertë. Kemi shumë nevojë për ndihmën që mund të japin ekspertët e KE-së. Unë kam pasur fatin t'i njoh dhe kam vlerësime të sinqerta, qoftë për zotin Reed apo të tjerë, sepse mund të kontribuonin dhe të fitonim shumë kohë.

Për çfarë duhet të fitonim kohë? Po ju jap disa argumente: diskutohet një fakt, përjashtimi i partive politike, që është nga pjesa e fundit dhe janë vënë disa elemente si: adresa, apo diçka tjetër, sigurisht që mund të jenë më shumë se kaq dhe ne nuk mund të mbetemi këtu, se vetë partitë politike dhe aktorët e tjerë kanë bërë propozime. Për shembull, një nga propozimet është: kur krijohen partitë në gjykatë marrin miratimin e tyre dhe regjistrohen nëse kanë 3 mijë firma anëtarësie, por nëse një parti për dy zgjedhje radhazi ka marrë më pas se 3000 vota sa nuk justifikon numrin e anëtarëve të partisë, unë do të thosha që kjo duhet riparë, sepse këto parti nuk kanë pse të jenë më në fushën e konkurrimit.

Së dyti, ne po themi që baza e financimit të partive politike në fushata elektorale ka një problem, që diskutohet, nëse do të jetë me fonde buxhetore apo jo dhe mund të diskriminohen parti të vogla që futen në garë dhe nuk mund të përfitojnë. Unë shtroj pyetjen: si do ta zgjidhim çështjen që Kodi Zgjedhor sot ka parashikuar që kanë të drejtë të fitojnë financime për fushatën zgjedhore vetëm partitë politike që kanë arritur 0,5% të rezultatit elektorale. Pra, të tjerat janë të përjashtuara nga financimet buxhetore.

A mos duhet një qasje tjetër? Nëse do të gjejmë qasjen se si do të jetë financimi, ndoshta do të derivojmë dhjetëra amendamente të tjera. Nëse nuk jemi ende para një vendimi politik, unë mendoj se do të bëjmë shumë tryeza të tilla, ku do të tregojmë sa të ditur dhe sa opinione kemi, por nuk do t'i shërbejmë me efektivitet punës.

Së treti, diskutohet lidhur me kthimin e diferencës ndërmjet të ardhurave që ka përfituar një parti politike (sipas propozimeve të sjella nga Këshilli i Europës) dhe shpenzimeve të kryera. Deklarohet se diferenca e shpenzimit që nuk justifikohet duhet të kthehet dhe penalteti është jashtëzakonisht i rëndë. Në rast se penalteti nuk kthehet për 5 vjet, kjo parti nuk financohet më.

Unë shtroj pyetjen: përse janë marrë këto financime? Sigurisht, janë marrë për të përballuar koston e fushatës elektorale.

Sa do të jetë kjo diferencë, nëse një parti ka marrë 500 milionë dhe nuk i ka përdorur të gjitha me efektivitet për nevoja të fushatës elektorale? Të paktën, ndër 500 milionë, 400 milionë i ka shpenzuar. Për 100 milionë, që nuk mund t'i paguajë, ju do të thoni se partia *x* e madhe nuk duhet të marrë për 5 vjet financime? Unë nuk mendoj kështu. Unë mendoj se ajo parti është e detyruar që në fushatën e ardhshme të kthejë shumën e detyrimit, plus kësaj edhe një gjobë, një sanksion, çfarëdo të jetë, por jo të shkojë deri në kategori të tilla.

Sot dua të jem shumë i kursyer në opinionet e mia, për sa kohë deputetët nuk janë shprehur me vendime, lidhur me mënyrat se si do të zgjidhet...

Cili do të jetë vendimi? Do të jetë vendimi për financimin buxhetor (unë për këtë jam, mbështes fort financimin buxhetor), që mbështetet mbi një kosto të nevojshme të organizimit elektorale? Pse? Sepse respektoj... Unë e dëgjova me shumë kujdes zotin Rid, i cili tha se duhet parë më shumë barazia proporcionale sesa strikte, por duke pasur parasysh që kemi të bëjmë me një proces me interes publik, palët duhet të jenë sa më afër mundësive për të realizuar një garë elektorale të barabartë, jo të ndryshme nga njëra-tjetra.

Unë po ju them diferencën në financim e një partie që sot është e përfaqësuar në parlament, me një parti tjetër të madhe: është 30-fish. Një parti, që është e përfaqësuar në parlament, sot merr 20 milion, një parti tjetër në parlament merr 600 milionë. Ku është barazia?

Unë nuk po ju them se barazia është strikte, por proporcionalisht, aq sa të jetë e mundur, të kemi një barazi në shanse. Është një parim mjaft i nevojshëm për të respektuar një proces elektorale. Unë, ashtu si një parti e madhe, kam nevojë të shkoj dhe të promovoj idetë e mia. Pra, ndoshta duhet parë edhe ky moment.

Së fundi, nuk e gjej me vend faktin që parashikohet që 2/3 e financimit të merret paraprakisht nga partia dhe të përdoret në dispozicion të fushatës elektorale si shpenzim dhe 1/3 të rakordohet me rezultatin e partisë. Pse? Sepse unë mendoj se financimi publik buxhetor jepet për nevoja të organizimit të fushatës elektorale, për vetë koston e fushatës elektorale. Partia politike nuk mund të rezervojë 20% të këtij fondi, që ta mbajë rezervë dhe më pas ta kthejë apo të mos e kthejë këtë rezervë.

Ndoshta edhe kjo mund të shkojë në harmoni me atë propozim që keni bërë ju, zoti Kuin, kur thoni se partitë i kanë marrë fondet dhe justifikohen që i kanë shpenzuar sipas nevojave të një fushate elektorale. Rezultati, lidhur me fatet financiare të asaj partie politike, nuk mund të

jetë vendimtar. Pasi është ndëshkuar një herë që nuk ka marrë mbështetjen e saj politike për alternativën që përfaqëson, tani të gjejë para borxh për të kthyer financat.

Kisha shumë nevojë të flisja, por rezervohem të them se në një grup ekspertësh... Unë i mbetem strikt bindjes sime. Kur ne të jemi në një terren konkret, kur deputetët të kenë një material, që t'ua kemi çuar paraprakisht, të jenë shprehur, qoftë për fushatën, qoftë për sistemin, qoftë për mënyrën e votimit... Të mos merremi sot me fletën e votimit, në qoftë se ne nuk dimë ende se cili është vendimi politik, nëse do të votojmë me fletë apo do të votojmë elektronikisht. Nëse ne do të harxhojmë seanca të tëra të tilla, do të thotë se nuk kemi arritur efektivitet, por kemi konsumuar kohë, që gati do të na çojë në pamundësi për t'iu përgjigjur zgjedhjeve të ardhshme, të paktën me rregullimet e nevojshme, sa të jetë e mundur.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi- Faleminderit, zoti Madhi!

Ky format tryeze përpiket t'i kapërcejë ndarjet midis deputetëve, ekspertëve, shoqërisë civile, ekspertëve të huaj. Ju inkurajoj që të kemi sa më shumë mundësi të themi atë që mendojmë, sepse sot nuk është një mbledhje vendimmarrëse, por është një mbledhje komisioni, pra ne na vlen shumë për të thithur të gjitha shqetësimet dhe sugjerimet. Sigurisht, më pas do të shkojmë në një mbledhje komisioni, e cila do të përcaktojë piketat mbi bazën e atyre që janë diskutuar edhe këtu, për të autorizuar më pas ekspertët për zgjidhjet përfundimtare.

Do t'ia kaloj fjalën zotit Rid, nëse ka komente për këtë çështje dhe më pas zonjës Schmid nga ODIHR për të bërë disa komente sipas OSBE-ODIHR dhe këndvështrimë për këtë çështje.

Quentin Reed: Për fondet shtetërore, dispozita e propozuar ku partia merr më shumë asistencë shtetërore sesa shpenzon në zgjedhje, kjo nuk është në ligj dhe do ishte një dispozitë standarde në shtete të tjera, nëse merr fonde shtetërore dhe nuk i shpenzon ato, atëherë kthen diferencën. Për sanksionet ndoshta mund të jetë e ashpër, por në këndvështrimin tim nuk më duket ashtu nëse nuk e justifikon sesi e shpenzon asistencën shtetërore atëherë nuk duhet ta marrësh për disa vite. Çështja tjetër lidhur me 2/3 dhe 1/3 të propozuar kjo është tentativë, qëllimi nuk është për të shpërndarë një pjesë para zgjedhjes dhe pjesën tjetër pas, por për mosndëshkimin e subjekteve zgjedhore për rezultatet që nuk i kontrollojnë, ka patur rezerva të shprehura ë parë se nëse e lëmë subvencionin siç është atëherë personat marrin gjithçka përpara dhe kanë akses duke e përdorur atë dhe ky ishte argumentimi për subjektet elektorale që duhet

të kthenin fondet. Financimi ndoshta duhet lënë siç është dhe të përqëndrohemi të çregjistrimi, nuk jam i sigurtë.

Oerd Bylykbashi Zj Schmidt.

Nicola Schmidt- Faleminderit për fjalën dhe faleminderit z. Reed për prezantimin e rekomandimetve. Dua të prezantoj disa parime që janë të rëndësishme për ODIHR. Rekomandimet tona janë fokusuar në çështje të transparencës dhe përgjegjësisë dhe kanë përfshirë aspektin e forcimit të raportimit dhe publikimit dhe gjithashtu mekanizmat e mbikqyrjes ku burime të mjaftueshme duhet të vihen në dispozicion KQZ-së për të përmbushur rolin dhe Z. Reed është thelluar në detaj gjatë prezantimit që bëri. Kjo përfshin edhe nevojën për sanksione dhe për efektivitetin e tyre dhe qëllimin frenues dhe mendoj se këto janë shumë të rëndësishme për tu konsideruar për të përmbushur Rekomandimet e ODIHR për fushatën zgjedhore. Do doja të thoja disa fjalë si e shoh fushatën zgjedhore dhe rëndësinë e çështjeve të barazpeshimit të pjesëmarrjen politike, jo vetëm votimin por edhe mbështetja e një partie nëpërmjet anëtarësisë, donacioneve dhe suportit financiar, liria e fjalës që në disa vende konsiderohet edhe kontribut financiar ose financimi i disa fushatave apo reklamave, për ta balancuar atë duke siguruar pluralizëm politik, mundësi dhe një proces të drejtë dhe është shumë e rëndësishme qasja e një debati të barabartë, qasja në këtë debat, por edhe mbrojtja e procesit zgjedhor nga korrupsioni dhe nga ndikimi i paligjshëm i grupeve të fuqishme që janë financiarisht të fortë.

Prandaj mendoj se është e rëndësishme të konsiderohet edhe financimi shtetëror edhe ai jopublik ky i fundit mund të jetë edhe mbështetje për partitë që nuk janë pjesë e pushtetit, partitë e reja që ndoshta nuk plotësojnë kushtet për financim shtetëror. Nga ana tjetër kur ke burime shtetërore mund të ndikosh pluralizmin e një zgjedhje mund të sigurosh barazinë dhe ulur rrezikun e korrupsionit.

Dy çështje do doja ti shtroja në tryezë dhe do doja edhe këndvështrimin e Z, Reed lidhur me të ashtuquajturin kontribut në natyrë për fushatën, ODIHR e ka përmendur në raport si ta vlerësojë këtë kontribut për shembul duke dhënë zyra për partinë apo ambiente pa pagesë dhe si duhet paguar dhe një çështje tjetër është financimi për palë të treta nëse kjo është diçka problematike në Shqipëri apo mund të përbëjë problem dhe duhet ndryshuar rregullimi ligjor për financimin e partive politike dhe fushatës zgjedhore. ODIHR kupton se të financohesh nga burime të pavarur për kandidatë të pavarur apo subjekte zgjedhore të pavarura me qëllim

promovimin e partive politike, kjo është diçka që duhet rregulluar, mbase kur të bëhen ndryshimet në Kodin gjedhor dhe Ligjin për Partitë Politike. Faleminderit.

Oerd Bylykbashi- Faleminderit, zonja Schmid, për kontributin dhe për referencat në lidhje me rekomandimet e OSBE-ODHIR-it, si dhe për çështjet që ngritët për diskutim!

Përpara se ta marrë fjalën zonja Meta, zoti Rid ka një koment.

Quentin Reed- Lidhur me dhurimet në natyrë dhe shpenzimet nga palët e treta, propozimet në mënyrë të veçantë parashikojnë kompetencën e KQZ për të nxjerrë udhëzim për vlerësimin e dhurimeve në natyrë. Këto udhëzime janë në fuqi pasi ne në fakt kemi asistuar në përgatitjen e tyre dhe janë në formatin e standartizuar të miratuar nga KQZ vitin e kaluar, nuk është gjithmonë e lehtë, por udhëzimet janë aty. Shpenzimet nga palët e treta, një nga arsyet pse propozova që të ketë përkufizime për shpenzimet, jo vetëm nga partitë por edhe nga subjektet për llogari të partive, kur një biznes paguan për një fushatë të një partie në zgjedhjet vendore për shembull duhet të konsiderohet qartë si dhurim në natyrë dhe sipas kotabilitetit duhet të deklarohet si shpenzim. Kemi mjaftueshëm në ndryshimet e propozuara lidhur me këto çështje ndoshta ka nevojë për plotësim dhe udhëzime të KQZ-së mbi këtë çështje.

Një nga çështjet që doja të rekomandoja dhe që është përmendur dhe në raportin e OSBE-ODIHR janë kërkesat e raportimit gjatë fushatës zgjedhore dhe kjo është shtruar si problematikë nëse partitë duhet të raportojnë gjatë fushatës apo jo. Qëndrimi im është se deklarimi i shpenzimit gjatë fushatës është jorealit pasi shpesh shpenzimi ndodh në kohë të ndryshme. Nuk bën sens. Nga ana tjetër publikimi i donacioneve duket më premtues si rrugë dhe është i diskutueshëm këtu dhe e di që Oerdi është kundër, me arsyetimin se mund të vendosë subjektet elektorale në opozitë në rrezik, pra nuk kam bërë një rekomandim të veçantë lidhur me këtë dhe duhet të shtrohet në diskutim.

Oerd Bylykbashi- Faleminderit, Quentin!

Zonja Meta ka fjalën.

Gerta Meta – Faleminderit bashkëkryetarëve të Komisionit të Reformës Zgjedhore për ftesën dhe, natyrisht, për dëgjesën dhe vëmendjen që ata kanë, në mënyrë të posaçme ndaj Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë!

Natyrisht, ky material që kemi sot do të ndihmojë procesin dhe të gjithë aktorët e interesuar, besoj, më shumë grupin e ekspertëve.

Ne, si Koalicion i Vëzhguesve Vendorë, jemi për vlerësimin e faktit që është i domosdoshëm një rregullim i ri, ligjor, i plotë, i jetës së partive politike, gjatë gjithë aktivitetit të tyre dhe jo vetëm për fushatën zgjedhore. Besoj se duhet të merret në konsideratë dhe të vlerësohet edhe nga grupi i punës.

Natyrisht, ne jemi ndër aktorët që kanë qenë shumë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e kemi thënë vazhdimisht që ky institucion duhet të vlerësohet dhe duhet të marrë fuqinë që i takon, qoftë ligjërish, qoftë në gjithë kolegjalitetin e vendimeve që ka dhe të arrijë këtë lloj, si të thuash, fuqizimi, si institucion i domosdoshëm, që merret me menaxhimin e proceseve zgjedhore në Shqipëri, për sa i përket këtij lloj fokusi në auditimin dhe në kontrollin e financimit të partive politike.

Është një moment i rëndësishëm për të vlerësuar se duhet një veprim ndërinstytucional me të gjitha institucionet kontrolluese, për mënyrën se si do të komunikojnë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe se duhet të jetë i detyrueshëm.

Për të arritur këtë lloj fuqizimi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të vlerësohet realisht si një komision teknik dhe i një niveli ekspertize të lartë dhe jo të vihet menjëherë në situata të vështira, ku ekspertët e fushës thonë se ka shkelje, si të thuash, në raportet e auditimit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vihet përballë sfidës për të thënë atë që kanë thënë ekspertët, ka apo nuk ka shkelje.

Kështu që është mirë të rishikohet, që Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t'i jepet haku dhe autoriteti i duhur për kontrollin e burimeve financiare dhe auditimit që ai bën nëpërmjet ekspertëve të ftuar prej tij.

Një moment shumë i rëndësishëm... Natyrisht, ne si Koalicion i Vëzhguesve Vendorë, kemi treguar që jemi seriozë dhe kemi qenë shumë zyrtarë edhe në komunikimin që kemi me Komisionin e Reformës Zgjedhore. Ne do të sjellim një material të shkruar, ashtu sikundër kemi bërë gjithmonë, duke pasur rekomandimet konkrete dhe sugjerimet tona për të ndihmuar procesin që në fund të fundit të kemi një reformë zgjedhore të finalizuar. Por një nga pikat që ne do të donim të ndanim me ju, ndoshta sot, është një nga momentet më sensitive, pikërisht momenti i financimit të partive në fushatën zgjedhore. Ne si koalicion gjykojmë se ndoshta ka ardhur momenti, duke analizuar të gjitha situacionet dhe problematikën që kanë pasur fushatat zgjedhore në Shqipëri, sidomos kur janë hedhur para për financimin e partive politike për t'i realizuar këto fushata zgjedhore, shumë problematike ka qenë transparenca e këtyre burimeve

financiare dhe ndoshta është një momenti i mirë të konsiderohen, sepse gjykojmë të ketë një financim total nga buxheti shtetëror. Kjo për disa arsye, për faktin se edhe politika ka gjykuar që edhe disa institucione që merren me kontrollin e burimeve të financimit të partive politike nuk e kanë vullnetin për të realizuar një transparencë maksimale të realizimit, të monitorimit dhe të financimit partive politike. Ndoshta, duke u konsideruar si para të buxhetit shtetëror, edhe legjitimiteti i kontrollit të plotë të strukturave audituese do të jetë edhe më i fortë, por kjo duhet të shoqërohet natyrisht me barrën e provës dhe t'u lihet personave që realizojnë auditimet apo raportet e auditëve.

Natyrisht kjo kërkon penalitete të forta dhe partitë politike të detyrohen të bëjnë transparencën e duhur, si dhe duke qenë para shtetërore do të ketë më respekt për këto para dhe për kontrollin e këtyre parave, pasi financimi shtetëror do të ndihmojë edhe ato që përmendën këtu faktikisht, në fakt, u tregua kujdes nga të gjithë aktorët për ta thënë, do të sigurohet një garë më e ndershme e subjekteve zgjedhore.

Pra, merakun që ne kemi është që të lejohet ky lloj pluralizmi nëpërmjet financimit shtetëror dhe në fund të fundit të ketë një hapësirë dhe mbështetje të drejtpërdrejtë edhe për kandidatët e pavarur, sidomos në zgjedhjet lokale, sepse të gjithë ne jemi dëshmitarë dhe kemi parë se çfarë ndodh me lojën politike drejtuar kandidatëve të pavarur.

Kjo ishte në tërësi për sa i përket asaj që ne duhej të ndanim, e cila ndoshta duhet konsideruar nga grupi i punës, grupi i ekspertëve apo në tërësi nga komisioni i reformës zgjedhore për diskutimin e një financimi të mundshëm total nga buxheti i shtetit.

Ajo që vlen të përmendet dhe ne duam të merret si një sugjerim i mirëkuptueshëm edhe nga bashkëkryetarët dhe anëtarët e komisionit të reformës zgjedhore, duke marrë shkas edhe nga një deklaratë publike që kemi bërë para dy ditësh, është se jemi në momentin e duhur që reforma zgjedhore të finalizohet. Ndoshta është një sugjerim pozitiv për grupin e ekspertëve, që ata të lënë çdo lloj angazhimi tjetër dhe të jenë këtu, duke u motivuar nëpërmjet mënyrave dhe mbështetjeve qoftë të aktorëve ndërkombëtare dhe kombëtarë që ata të mundën dhe të kenë të gjithë programin, rekomandimet dhe sugjerimet e duhura, në mënyrë që edhe ne të jemi të drejtpërdrejtë në mesazhin që duhet t'u japim qoftë aktorëve kombëtarë, qoftë qytetarëve shqiptarë apo qoftë edhe ndërkombëtarëve, të cilët janë shumë të shqetësuar për realizimin dhe finalizimin e një reforme zgjedhore në Shqipëri. Vazhdimisht kemi thënë se kemi zgjedhje në qershor të 2019-ës dhe i gjithë kuadri ligjor dhe reforma zgjedhore, duhet të kenë përfunduar

gjatë këtij afati kohor. Mendoj se duke konsoliduar gjithë kontributin e përbashkët qoftë ne si aktorë kombëtarë, qoftë edhe aktorët ndërkombëtarë, të ndihmojmë grupin e ekspertëve që të jenë më të orientuar për ta realizuar punën e tyre në vazhdim.

Ju faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, Gerta!

Fjalën e ka zoti Rusmali.

Illir Rusmali – Faleminderit!

Në fakt, doja të bëja disa pyetje, të cilat mund të kenë vlerë për t'u diskutuar, por paraprakisht dua t'ju them se e çmoj shumë materialin e Quentin Read. Si gjithmonë edhe këtë herë është mjaft i kompletuar dhe i trajton në tërësinë e vet problemet, prandaj nuk do të doja që pyetjet e mia të konsiderohen si rezerva ndaj materialet, sepse siç çmoj materialin çmoj shumë edhe bagazhin e zotit Read, prandaj dua të bëj pyetje, të cilat mund të duken pak si antagoniste me materialin.

Pyetja e parë: a do të kishte vlerë për situatën e reformës ku ne jemi sot, të imagjinohej eventualisht vendosja e një sistemi ligjor unik për financimin e partive politike dhe të fushatës në të gjithë kompetentët e saj? Në zgjedhjet e shkuara ne kemi diskutuar gjatë në rrethe të ndryshme, skemat janë të ndryshme nga njëra-tjetra, limitet ose dyshemetë që përcakton financimi i partive politike në vitin normal të aktivitetit janë të ndryshme nga limitet apo dyshemetë që përcakton fushata zgjedhore. Mënyra e mbikëqyrjes, e auditimit, procedurat, modalitetet janë të ndryshme dhe shumë gjëra të tilla. A mos do të ishte me vlerë për Shqipërinë të thoshim që sistemi është një, nuk ka rëndësi është fushatë zgjedhore apo aktivitetet i zakonshëm politik? Kemi një sistem financimi, një sistem monitorimi, një sistem kontrolli, një sistem procedurash, një sistem ndëshkimi. Diskutimi ndoshta nuk është vetëm për financimin, por financimi është më i prekshëm, tendenca në Shqipëri për të krijuar sisteme alternative, sisteme paralele, sisteme konkurruese edhe në fusha të tjera ka prodhuar vazhdimisht mosrespektim të ligjit, shkelje të tij, devijime nga kërkesat, rregullat apo detyrimet. Mos ndoshta duke shkuar te një sistem mund ta bëjmë më të lehtë zbatimin?

Pyetja e dytë. Meqenëse jemi prapë në kuadër reforme, a ka vend të diskutojmë eventualisht mekanizmin që kemi sot në fuqi të auditëve financiarë? A mund të ketë zgjidhje alternative që prodhojnë më shumë seriozitet në procesin e kontrollit të financave që i bëjnë më

realiste ato dhe jo formaliste, siç i kemi pasur ne deri më sot? Ndoshta mund të kishte vlerë që ne ta eksploronim si alternativë, sepse edhe mund të ishte e dobishme për reformën.

Pyetja e tretë, kjo dikujt mund t'i duket sikur është jashtë teme. Kuadri ynë ligjor që herët ka një dispozitë jetime, të paktën kështu më duket mua, dispozitën, mekanizmin e nëpunësve ndërlidhës. Nëpunësit ndërlidhës, kur janë futur në sistemin tonë ligjor, janë futur si mekanizëm për të kontrolluar keqpërdorimin e burimeve publike, kur u futën atëherë dhe besoj se jemi të vetëdijshëm të gjithë që nuk funksionojnë si të tillë. Pra, ata nuk janë kalorësit e ligjit që do të pengojnë ministrat të abuzojnë me pushtetin që kanë në fushatë zgjedhore. Mos vallë duhet riparë edhe ky mekanizëm? A mund të kishte vlerë në debatin për financimin?

Pyetja e fundit ose çështja e fundit. Unë e di, por më duket sikur edhe këtu del nga pak, në Shqipëri, sidomos në temën e financimit jemi gjithmonë si ai qeni që vjen rrotull për të kapur bishtin e vet dhe nuk arrin ta kap kurrë. Çfarëdolloj gjëje që ne mendojmë për të trajtuar problemet që kemi me financimin diku do të na çojnë të kafshojmë bosh. E çmoj shumë seriozisht, por dua ta marr si shembull, sepse më duket se ilustron idenë, prandaj duhet trajtuar seriozisht, për financimin nga buxheti i shtetit. Por rreziku i kësaj ideje, përveç komoditetit që ka, që ta bën më të lehtë fushatën, sepse burimet e financimit i kemi të siguruar nga buxheti, është:

E para, do të kalojë 100% në ilegalitet financimin privat.

Së dyti, për shkak se e kalon në ilegalitet do ta shumëfishojë financimin privat. Kjo do të thotë që një ide e mirë, racionale, e dobishme për kushtet e Shqipërisë, mund të çojë në një pasojë ekstremisht negativ, pra në një kapje më të fortë nga oligarkia, krimi i organizuar, nga pushteti i biznesit në politikë. E thashë për ilustrim, për të thënë se gjithmonë ka një rrezik që është më i madh sa kohë që nuk ka një vullnet të fortë politik të vendosim rregullat dhe t'i qëndrojmë me fanatizëm atyre. Në këtë logjikë politike që kemi ne besoj se do të kishte vend që ne të puntonim më shumë te reforma drejt reduktimit të shpenzimeve gjatë fushatës se sa tek konceptet e tjera të reformës, siç është transparenca, duke nënkuptuar që reformë për reduktimin e shpenzimeve automatikisht do të thotë reformë për reduktimin e aktiviteteve, sepse shpenzimi bëhet për një aktivitet.

Pra, nuk do të përmendim kuota shpenzimesh, por duhet të themi: jo më shumë se kaq aktivitete të kësaj natyre. Mund të kishte vlerë, dhe këtu e kemi ilustrimin shumë të mirë nga materiali quantin. Shqipëria nuk ka nevojë për reklamë elektorale në televizion. Madje nuk është

më në qëllimet e fushatës. Reklama elektorale në televizion përveçse është kosto ekstreme për partitë politike, është kthyer në dhunim të zgjedhësit jo në informim të zgjedhësve, ndërkohë që qëllimi primar i fushatës dhe i mbështetjes financiare të saj është që fushata të arrijë zgjedhësin, të shkojë tek ai. Tezat, platformat, qëndrimet, angazhimet politike të kapin zgjedhësin, me qëllim që, kur ai të votojë, të jetë i vetëdijshëm për vullnetin e vet. Nuk mundet që unë të të bombardoj ty nga mëngjesi deri në darkë dhe ti të mos kesh shpëtim prej meje. Kjo ndodh në Shqipëri. Mbase nuk duhet bërë si me modelin jo reklamë, mund të ketë edhe dispozita të tjera, jo kjo natyrë aktivitetesh ose diçka e ngjashme.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Rusmajli!

Për pyetje, të cilat ngacmojnë diskutimin tonë më tej, duke riprekur çështje të hapura që në fillim ose edhe gjatë bisedave dhe duke i sjellë në fokus, unë do të ndalem vetëm në një moment të shkurtër, tek një hapësirë në lidhje me pikën e parë, sistemin unik të financimit. Për shkak se financimi është rregulluar në dy palë reforma të ndryshme, në vitin 2008 me Kodin Zgjedhor dhe më vonë në ligjin për partitë politike dhe për dinamikën proceseve të asaj kohe ne nuk patëm mundësinë edhe pse ishte qëllimi realizimi uni dhe sot jemi peng i kësaj dhe ndoshta është momenti për ta thyer dhe për të ardhur në një sistem unik dhe të thjeshtë, i cili ndikon drejtpërdrejtë tek transparencja dhe monitorimi, pra thjeshtësia e sistemit.

Nëse në një vit që i bie të jetë zgjedhor do të marrin më shumë para, është çështje volumi parash, por nuk ndryshojnë rregullat, nuk ndryshojnë sanksionet, nuk ndryshon monitorimi e të tjera. Kështu që unë do të ftoj ta shohin edhe ekspertët të shohim mundësinë shkuarjes drejt një sistemi, më pas e vendosim me ligj.

Quentin Reed- Në fakt aty është synimi i propozimeve. por ta shtrijmë më tej, çfarë tjetër propozoni të ndaloni, është rekomanduar aty tashmë dhe është shumë e zgjeruar dhe aktivistët e lirisë së medias dhe grumbullimit do e godisnin këtë , pavarësisht interesit publik për të reduktuar ndjeshëm shpenzimet e fushatës por ndalimi i mëtejshëm do ishte i vështirë.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, Z. Reed!

Në fakt, është një nga qasjet në këtë komision në aspektin politik dhe uroj që të mund ta kemi edhe mbi bazën e ekspertizës, edhe të asaj që po diskutohet në këtë tryezë, të shkojmë drejt zgjidhjeve që do të ndihmojnë në këtë linjë. Në vitin 2016, në komisionin e reformës, atë komision, i cili nuk funksionoj, është propozuar se një nga qasjet ishte pikërisht reduktimi i shpenzimeve, aktiviteteve, i materialeve qoftë edhe nëpërmjet një liste specifike sendesh,

objektsh apo aktivitesh, të cilat jo vetëm do të kostoeshin publikisht, por edhe do të limitoheshin, apo mund të ketë edhe ndalime, siç sugjeroni ju rastin e reklamës me pagesë në televizione.

Ne sot kemi një mbulim mediatik të kushtueshëm për financat e partive politike, i cili është i ndaluar nga ligji. Nuk është marrë asnjë sanksion për të, është quajtur si një zhvillim natyral, por, në fakt, transmetimi me pagesë apo pa pagesë është i ndaluar nga ligji. Ligji nuk e lejon të transmetohet *live* aktivitetin zgjedhor. Kodi Zgjedhor e disiplinon në mënyrë specifike, me një koncept të tijin për të krijuar ato që janë kushtet e barabarta mes palëve, sepse jo vetëm do të jenë raportet kohore të mbulimit në një mënyrë të caktuar, por edhe cilat do të jenë ato aspekte të mbulimit mediatik, sigurisht këto do të diskutohen në një tryezë tjetër që do të bëhet, por çështjet kryqëzojnë. Cilat do të jenë ato mënyra të mbulimit mediatik që do të garantojnë barazinë mes palëve, por në rastin konkret do të mbante në kontroll edhe financat e palëve? Janë lajmet, edicionet speciale informative për fushatën, reklamat në televizione dhe debatet. Këto janë katër format e vetme të lejuara nga Kodi Zgjedhor. Nuk ka formë tjetër të lejueshme.

Pra, aktualisht është zhvilluar një praktikë e paligjshme, e pandëshkuar dhe tashmë është kthyer në një aktivitet me kosto financiare dhe interes shumë të lartë nga televizionet publike, por me një pasojë shumë të rëndë në financat e partive. Mbulimet *live* të aktiviteteve dhe, sigurisht, njëra palë, e cila dominon më shumë dhe detyron tjetrën ta ndjekë, partitë e vogla nuk janë në gjendje ta mbulojnë. Pra, nëse ne do të jemi më specifike, unë përmenda një rast, një rast tjetër e përmendi zoti Rid, apo mund të kemi kufizime në numër aktivitësh fushate për të mos bombarduar pafund me aktivitete, por për të bërë atë që është e nevojshme gjatë një fushate, të gjitha këto do të çojnë në reduktim shpenzimesh. Për shembull, një çështje tjetër është se ka parti politike që hapin zyra elektorale thjesht për të pasur posterin te fasada e xhamit. Është kosto, dominojnë territorin, por nuk kanë efekt elektoral të llojit të funksionimit të strukturës politike zgjedhore në aksesin te zgjedhësit, por është një turr force vizive për palën kundërshtare apo për elektoratin me kosto. Edhe këto mund të reduktohen, sepse, nëse është një strukturë zgjedhore që shërben për një kontakt, edhe kjo ka një raport për numër zgjedhësish, që do të çonte në reduktim të shpenzimeve dhe të tilla mund të kemi. Pra, këto janë ide në të cilat është ecur në një farë mase me ato amendamente të pjesshme të vitit 2017, por që në këndvështrimin tonë, dhe uroj që do të gjejmë një kompromis ndoshta jo këtu, por në komision, që ne të shkojmë drejt reduktimit të shpenzimeve duke reduktuar aktivitetet apo *items*, ato që arrijmë të shpenzojmë.

Një subjekt zgjedhor para pak zgjedhjesh ka shpenzuar rreth 2 milionë euro në fushatë publicitare me reklama, kjo e llogaritur nga numri i reklamave të transmetuara dhe nga kostoja që dihet publikisht. Kjo mund të krijojë një model që mund të ndiqet më pas, i cili sjell influencën e parasë korporatave, dominimin që do të bëjë mbi politikat më pas interesi i këtyre kompanive që kanë financuar etj. Pra, çështjet lidhen me njëra-tjetrën, kështu që ne duhet ta eksplorojmë, në gjykimin tim, këtë hapësirë.

Zoti Fino kërkoi fjalën.

Bashkim Fino – Faleminderit!

Ju falënderoj për këtë material që të gjithë e vlerësuan me shumë pozitivitet!

Jam i fushës së ekspertëve kontabël dhe nuk besoj të flas me fjalë të jashtëzakonshme, që është nga më të mirët. Ky është një informacion, jepen shembuj, jepen amendamente të ndryshme, të cilat na tregojnë mundësinë se si mund ta rregullojmë transparencën e fondeve politike. Konkluzioni im është që grupi ekspertëve i të gjitha partive politike, duhet ta marrë këtë material shumë të mirë dhe, natyrisht, duhet të punojë edhe për ato që kanë ndodhur në Shqipëri në gjithë këto vite, për shkak të transparencës, për të paraqitur më pas, në komisionin tonë, ato nene dhe amendamente që duhet të realizojmë.

Çfarë dua të them me këtë? Më pëlqyen dy pyetje të zotit Rusmajli, ose më interesojnë mua më shumë, pyetjet 2 dhe 4, pra mekanizmi i auditimit dhe financimi nga buxheti i shtetit.

Ekspert kontabël është një profesion i lirë, që merr licencën dhe varet nga shoqata e ekspertëve kontabël. Pra, merr një lloj licence të caktuar, që do të thotë se mekanizmi që do të bëjnë këta ekspertë kontabël, do të jetë i thellë, transparent, i drejtë, i ndershëm, që të mos kthehet, siç tha Rusmajli me të drejtë, në një kontroll formalist dhe që pastaj të certifikohet nga KQZ-ja. Pra, KQZ-ja i thotë një eksperti kontabël “ik kontrolloje Partinë Socialiste”, po marr shembull partinë time që të mos bezdis Mediun, se kam edhe shembull nga partia e Mediut apo nga partia kundërshtarë e PD-së. Për shembull, le të themi: “PD-ja është akuzuar për fonde ruse”. Unë dua të di si qytetar dhe jo si politikan, a është e vërtetë një gjë e tillë? Kush e bën këtë mekanizëm që ta nxjerrë të vërtetën nëse ai e ka marrë këtë fond? KQZ-ja? Absolutisht jo! Dhe a e dini pse nuk e bën?! KQZ-ja në fund të fundit është politike. Aty ka nga PS-ja, nga PD-ja, nga LSI-ja. Vërtet unë mund të jem ekspert kontabël me licencë të rregullt dhe dua të ruaj kokën time për të kryer aktivitetin gjatë vitit për licencën që marr, por në fund të ditës do të çoj te KQZ-ja një material, për të cilin do të kem një përplasje. Prandaj, që mekanizmi i auditimit të mos

kthehet në formalitet, duhet të gjejmë mekanizmin se si duhet bërë realisht një kontroll i tillë që të jetë shumë i domosdoshëm. Nuk jam absolutisht dakord me atë që tha Rusmajli në mënyrë kategorike, jo financimi nga buxheti i shtetit. Në mënyrë kategorike nuk zgjidhim gjë me financim nga buxheti i shtetit për aktivitetin e partive politike. Absolutisht, jo. Përkundrazi është e vërtetë që nën dorë, nën tryezë do të rritet financimi ilegal i atyre që kanë dhe duan të paguajnë për fushatën zgjedhore të partive të ndryshme politike. Unë mendoj se nuk zgjidhim gjë me këtë, përkundrazi u rrisim fondet financiare më shumë edhe në rastin që tha zoti Bylykbashi këtu, që do të ulë apo do të kornizojë si të thuash aktivitetin do të rriten më shumë fondet financiare të partive politike. Disa do t'i marrin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit, disa do t'i marrin nën dorë, nën tryezë dhe nuk do t'i marrë vesh njeri...

Pra, pyetja që kam unë për ekspertët, dhe këtë e kam shumë dashamirëse, ju lutem më dëgjoni me kujdes! Mbas këtyre që ju thatë, mbas këtyre që dëgjuat më shumë nga ekspertët dhe nga ne, si politikanë, sa për qind do të rritet transparenca e fondeve për partitë politike, në funksion të këtij materiali që ju na keni servitur, që ekspertët tanë ta shohin dhe ne duhet ta adoptojmë si Komision i posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, për ta kthyer në ligj dhe të fitojmë vërtet një përqindje të jashtëzakonshme të transparencës? Ky është thelbi i të gjithë diskutimit të kësaj tryeze. Nëse ma thoni me përqindje këtë (sado që të jetë), të jeni të bindur se në një farë mënyre u keni kthyer përgjigje në mënyrë të ndershme 4 pyetjeve të Rusmajlit.

Faleminderit!

Bledar Çuçi - Nuk ka përgjigje, Bashkim.

Zoti Skënderi, fjala për ju!

Bledar Skënderi – Përshëndetje!

Unë jam anëtar i KQZ-së. Me Kod Zgjedhor dhe me Kushtetutë, ne jemi organ i pavarur, pavarësisht se jemi propozuar nga partitë politike.

Do ta vlerësoja shumë materialin e ekspertit, por duke qenë se eksperti, me sa mora vesh unë, ka që nga viti 2009 që vjen në Shqipëri, ai ka vetëm përvojën e reformës së fundit zgjedhore.

Ne që kemi më shumë eksperiencë me reformat e dimë si ndodhin reformat këtu, në Shqipëri. Një ditë të bukur maji mbledhen dy bashkëkryetarët dhe vendosin. Ata thonë se do të

ketë vetëm financim publik për partitë politike, do të ngrihet një autoritet të pavarur, jashtë KQZ-së (meqë kjo e fundit qenka e varur) dhe i gjithë materiali i ekspertëve bie poshtë.

Gjithsesi, duke menduar se kjo nuk do të ndodhë, se është një ëndërr e largët, ne po marrim si qëllim përmirësimin e këtij materiali dhe kësaj baze ligjore që kemi, unë kisha disa pyetje për ekspertët:

- A duhet të ketë limit edhe për partitë politike, edhe për koalicionet? Mund të ndodhë që unë të bëj një koalicion me 50 parti politike dhe eksperti mund të vendosë 2-fishin e fondit që merr partia politike më e madhe nga buxheti i shtetit dhe rezulton se 50 parti herë këtë fond, del fondi 100 milionë euro, ndërsa partia tjetër përballë ka vetëm 2 milionë euro për të shpenzuar. A krijojmë pabarazi midis palëve?

- Ndalimi për përfitimin e fondeve publike është 2 vjet. Pse nuk e lidhim me mandatin qeverisës dhe nga 2 ta bëjmë 3?

Jo, zotëri unë fitoj zgjedhjet dhe kam mandat 4-vjeçar. I premtoj atij se vitin e katërt, mbas afatit 3-vjeçar do t'ia jap të gjithë tenderët si subjekt ndërtues. Mandati duhet lidhur me mandatin qeverisës (sa të jetë ai 2-3-4 vjet) pa e specifikuar me vite, sepse për momentin, po kalojmë nga faza 4+4 te faza 4x4, siç duken punët.

- A duhet të rritet numri i personave, të cilëve u kufizohet marrja e fondeve publike? Për shembull: personi që ka qenë kandidat në një listë zgjedhore për deputet. Gjatë gjithë mandatit 4-vjeçar që propozova unë, ai nuk duhet të marrë asnjë fond publik. Unë mund të marr një person dhe ta fus në fund të listës duke i thënë: "S'ka gjë që ti nuk fiton si deputet, se unë do të të jap nesër një tender apo diçka tjetër dhe ti mund të financosh fushatën zgjedhore".

Këtë mund ta rrisim edhe me personat, të cilët nuk janë kandidatë për deputetë, por mund të merren aktivisht me fushatën si përgjegjës për një zonë të caktuar apo kanë rol aktiv në fushatën e një subjekti zgjedhor.

- A duhet fuqizuar KQZ-ja, që të marrë një rol aktiv në kuadër të financimit të partive të ndryshme politike, apo thjesht duhen angazhuar edhe institucionet e tjera? KQZ-ja, pavarësisht sa i varur mund të jetë, siç tha zoti Fino, nuk ka të drejtë të bëjë rolin e oficerit të Policisë Gjyqësore, as të hetojë, as të kërkojë llogari, as t'u dërgojë shkresa institucioneve të huaja, por thjesht mund t'ia referojë, nëse ka një problem, prokurorisë apo organeve të tjera ligjzbatuese që merren me hetimin, që të hetojnë më thellë.

Kaq të drejtë ka KQZ-ja, të konstatojë dhe t'u kërkojë organeve të tjera të hetojnë më thellë për këtë problem.

- Duhet një mekanizëm për ekspertët financiarë. Ne sot e kemi një ekspert financiar. Po të dojë ai, e kemi me të drejtë zgjedhjeje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, e para duhet të shprehin interes ekspertët, që duan të merren me këtë punë dhe pas kësaj, ne e hedhim në short për të gjitha partitë politike që janë.

A duhet një mekanizëm detyrues edhe për shoqatën e ekspertëve financiarë që të na sjellë listën e ekspertëve më të mirë, që do të merren dhe do të auditojnë një parti? Sepse mund t'i takojë një ekspert, i cili mund të ketë ndonjë biznes të vogël atje, të auditojë partinë e zotit Fino, apo atë të zotit Alibeaj.

- Një çështje shumë thelbësore e kam në fushën e medieeve. Unë kam dy fëmijë. Vajza e madhe është 9 vjeçe. Unë kam 8 vjet që nuk shoh televizor, sepse nuk ma lënë fëmijët në shtëpi. Dua të shoh televizor, por nuk mundem, sepse nuk më lënë fëmijët dhe gjithë kontaktin me botën e jashtme e kam nëpërmjet rrjeteve sociale. Ne themi të kufizojmë kohën që jep televizioni. Ka ikur kjo kohë, zotëri. Nuk sheh njeri televizion. Të gjithë informacionin njerëzit e marrin nëpërmjet rrjeteve sociale. Në zgjedhjet e fundit në SHBA, në bazë të një sondazhi, 64% e votuesve ishin influencuar nga rrjetet sociale (*Facebook, Tëitter, Google*).

Sot ne vendosim kohë televizive, në një kohë kur njerëzit e kanë vënë në muze atë. Ata shohin gjithë ditën rrjetet sociale (Balcanëeb-in, Temën, Syri.net) me celular. Nuk ka njeri kohë fizike për të parë televizorin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë, si i pavarur që jam, i shoh të gjitha.

Bledar Çuçi - Meqenëse pyetjet ishin shumë serioze, megjithëse shumica këtu po i merr me të qeshur, unë pres një përgjigje nga eksperti.

Faleminderit!

Faleminderit, zoti Skënderi!

Kemi pasur standardin që një anëtar, i cili propozohet nga maxhoranca, mban ekuilibrin dhe bëhet asnjë, por standard që një anëtar, i cili propozohet nga maxhoranca të jetë kaq në sintoni me qëndrimet e opozitës, është rasti i parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gati është, zoti Mediu.

Përtej shakasë, do të marrim disa përgjigje nga eksperti.

Quentin Reed - Për pragun për shpenzimet që është pyetja juaj, jam i kënaqur që e ngritët këtë çështje sepse nuk ishte për palët e treta por për subjektet elektorale. Duhet të jetë fondi total i shpenzimeve nga një subjekt zgjedhor, partitë që duhet të raportojnë fianancimin e fushatës zgjedhore aty bëhet me e komplikuar. Për kontratat shtetërore përse jo, le të jetë ndalimi për katër vite, por duhet të përcaktohet në vite dhe jo sipas mandatit pasi është shumë e ndërlikuar pastaj si koncept, çfarë ndodh nëse bie qeveria. Nëse KQZ ka një rol madhor, mendoj se propozimet këtë rol i japin, nëse duhet të kufizohet me IEKA nuk jam ekspert, por mendoj se duhet të kufizohet me ta perderisa janë organ i njohur nga ligji dhe ekspertë.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Rid!

Përpara se ta mbyllim, ka pyetje ose ndonjë koment tjetër?

Po, zoti Biba.

Denar Biba – Nuk kam ndonjë pyetje, por ndoshta ndërhyrja ime mund të përkufizohet si koment dhe është më tepër një tërheqje, krejt miqësore, vëmendjeje.

Duke qenë se ju do të jeni ata që do të hartoni rregullat, do të normoni këtë situatë të ardhshme, dua t'ju kujtoj, me një lloj theksimi, ndoshta edhe anormal, kontekstin në të cilin ju po e bëni këtë proces, ku fjala e ditës ose një nga fjalët kryesore të ditës është vetingu.

Në të kuptuarin tim, edhe ky lloj procesi ka një dimension vetingu, pasi ju po tentoni të bëni vetingun e financave të partive politike dhe e vetmja tërheqje vëmendjeje nga ana ime është që ju të kini koshiençën e asaj çfarë po ndodh me vetingun, në mënyrë që ky rregullim, ky normim, që ju po e bëni në laborator, të mos krijojë ose të ketë garancitë e mjaftueshme ligjore dhe kushtetuese që nesër, pasnesër, kur të përkthehet në zgjidhje dhe në vendimmarrje reale të përditshme, të mos penalizojë individë apo struktura politike në mënyrë të tillë që, duke u kthyer mbrapsht, pastaj edhe ju vetë të parët të thoni: çfarë bëmë kur ne e normuam këtë situatë?!

Pra, ndërhyra vetëm për të tërhequr vëmendjen, për të bërë një sugjerim krejt shoqëror dhe profesional, që ky veting i financave të partive politike dhe i kandidatëve të pavarur të mos bëhet pa garancitë ligjore dhe kushtetuese për këta individë.

Nuk dua të hap asnjë lloj debati, por mora shkas edhe nga shembulli ose sugjerimi që bëri zoti Mediu kur tha se, fare mirë, gjatë fushatës elektorale dikush blen vota dhe kandidati, pa asnjë lloj penalteti, bëhet deputet, partia e tij fiton...

Përfytyroni situatat hipotetike, që mund të mos jenë vetëm të tilla, por nesër, pasnesër, mund të jenë një realitet tipikisht vrastar, kur kandidati kundërshtar mund të inskenojë një situatë, ku njerëz pranë një kandidati të caktuar të kapen nga mediet, duke blerë vota dhe kandidati përkatës të penalizohet, sepse njerëz të grupimit të tij politik ose pranë tij, me vetëdije ose pa vetëdije, kanë rënë në kurthin e kandidatit kundërshtar. Pra, kujdes çfarë do të bëni. Mendoni fillimisht për garancitë ose në momentin që do të mendoni për zgjidhje, mendoni njëherazi edhe për garancitë që do t'u jepni partisë politike dhe individëve.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Biba!

Fjalën e ka zoti Mediu për një sqarim.

Fatmir Mediu – Për ta sqaruar, unë nuk thashë se, në mënyrë apriori, hipotetike apo qoftë edhe deklarative, ky është i filanit, por në qoftë se personat kanë një autoritet politik brenda një strukture ose janë të lidhur, të provuar, kjo pastaj i takon procesit.

Në qoftë se gjykata e përcakton fajtor për një çështje të tillë, përcakton edhe raportin që ai ka me subjektin përkatës, unë nuk mendoj se ka ndonjë gjë të keqe që ne të penalizojmë qoftë kandidatin, qoftë subjektin politik, pasi nuk kemi si ta shmangim.

Natyrisht, ju ngrini një gjë të drejtë, se mund të ketë manipulime të tilla, që mund të krijojnë probleme, ama manipulimin nuk e kemi në këtë drejtim sot, por në drejtimin tjetër.

Denar Biba – I nderuar zoti Mediu, ma lejoni këtë!

Këto që sapo ju thatë, janë garancitë që unë kërkoja. Përndryshe, nëse ju, nëpërmjet legjislacionit, le të ngremë një paralele, ia vendosni edhe barrën e provës kandidatit, që të provojë se nuk ka qenë ai që e ka nxitur këtë situatë korruptive më the, të thashë, mund të bini pastaj në disa paradokse, nga të cilat nuk do të dilni dot ju më të parët.

Fatmir Mediu – E kemi lënë ne, për shembull, barrën e provës; ua kemi lënë në veting gjyqtarëve. Domethënë, në qoftë se ka bërë fotografi me një person të caktuar, i mbetet atij të provojë se nuk ka ndonjë raport të caktuar me të.

Denar Biba – Unë nuk po i hyj më kësaj pune, se këtu mund të dalim pastaj politikisht jokorrektë dhe është jashtë kësaj situatë. Por...

Fatmir Mediu – Pa dyshim, unë jam për prova, domethënë jo jashtë provave. Të gjitha të argumentohen...

Denar Biba – Sugjerimi im ishte vetëm për garancitë e një procesi, i cili mund të ketë penalitete.

Oerd Bylykbashi – Faleminderit!

Zoti Krasniqi ka diçka shkurtimisht.

Afrim Krasniqi – Duke përfituar nga rasti, jashtë rendit të ditës, por meqenëse është komisioni dhe besoj jemi në mbyllje, këtu janë një numër organizatash, që raportojnë për Shqipërinë në misionet ndërkombëtare dhe një nga kriteret që na kërkohet është raportimi për ecurinë e Komisionit të Reformës Zgjedhore.

Ne e kemi shumë të vështirë të japim informacion, sepse, me përjashtim të rrisë, që në tryezë është shpërndarë një kalendar pune, ne nuk kemi një produkt dhe një afat për produkte. Komponenti i transparencës publike, që duhet të ishte publikimi i të dhënave në faqen zyrtare të Kuvendit, nuk ka ndodhur ende.

Sugjerimi ynë është, të paktën imi, që komisioni duhet ta shikojë me vëmendje këtë gjë dhe të arrijë të prodhojë një kalendar strikt afatesh, në mënyrë që në mes ose në fund të qershorit, kur do të ketë një vlerësim dhe kur ne do të duhet të japim një lloj vlerësimi, siç e jep shteti, e jepni ju në këtë komision, e jep edhe shoqëria civile, të kemi një produkt, në mënyrë që pastaj secila palë të mos e paragjykojë tjetrën dhe të jemi realistë në parashikime.

Frika ime është që, siç ka ndodhur në të kaluarën apo edhe në mandatin tuaj të parë, edhe të këtij komisioni që u shty, nëse nuk kemi një draft konkret nga ekspertët, shumica e të cilëve nuk ndodhet as tani në sallë, do ta kemi të vështirë për të parë dhe për të shpresuar që ky komision është ndryshe nga komisioni që ju keni drejtuar mandatin e kaluar.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Krasniqi, për komentimin!

Në fakt, pikërisht për të vlarë frikën që ju shprehni, ndryshe nga komisioni tjetër, ky komision ka miratuar jo vetëm planin e punës, por edhe kalendarin. Sigurisht, kalendari i këtij komisioni lidhet me atë që është e mundshme, nëpërmjet një procesi normal të ecë përpara, që parashikon se deri në periudhën qershor-korrik të mbyllet ajo që na kërkon OSBE-ODIHR-i: të hartojmë politika të arsyeshme për zgjidhjet që do të vijnë më pas.

Diçka do të ecë më ngadalë, diçka do të ecë më shpejt mbi bazën e një kalendari, i cili është i miratuar dhe është publik, mbi të cilin monitorohemi edhe ne.

Deri në këtë moment aktivitetet kanë ndodhur sipas këtij kalendari. Kjo është tryeza e dytë, e cila i jep mundësinë komisionit që, sapo të zbardhen aktet e këtyre diskutimeve, ekspertët dhe komisioni të fillojnë të marrin vendimet përkatëse, për të autorizuar ekspertët për t'i draftuar.

Do të ketë draftime që do të ndodhin më herët, do të ketë draftime që do të ndodhin në korrik, do të ketë draftime që do të ndodhin edhe më vonë. Pra, nuk lidhet me procesin e raportimit apo të vendimmarrjes së qershorit, por është kalendar pune (i miratuar nga komisioni) shumë i ndryshëm nga komisioni i kaluar dhe është publik. Kjo ishte sa për të bërë të qartë se nuk mund të krahasohen dy gjëra të pakrahasueshme, por ekspertët nuk mund të fillojnë ende të draftojnë dhe më pas ne të bëjmë tryeza politikëbërëse në kuadrin e reformës zgjedhore, sepse më pas do të përmbysnim konceptin themelor, me të cilin jemi bazuar në hartimin e kësaj pune. Nuk e di, por ndoshta ndaj të njëjtin qëndrim me zotin Çuçi për sa i përket kësaj dhe duke reflektuar vendimmarrjen e komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni një koment tjetër?

Vildan Plepi – Shumë shkurtimisht, pasi besoj se jemi në përfundim të mbledhjes. Vij nga zyra e Institutit Demokratik Amerikan. Kam vetëm një çështje, të cilën nuk e dëgjova të ngrihej për diskutim edhe aq shumë sot lidhur me palët e treta: me financimin apo ndikimin që mund të kenë palët e treta në fushatat zgjedhore.

Mendoj se legjislacioni aktual ka një boshllëk total për sa i përket rregullimit të palëve të treta në fushatë. Pa diskutim që nuk është e lehtë. Ne kemi zhvilluar takime me ekspertë të huaj, të cilët na kanë sjellë rastin e Anglisë, ku çdo palë e tretë që kërkon të ketë rol në fushatë duhet të jetë e regjistruar. Pra, nuk mund të kontribuosh në fushatë, në mënyrë direkte apo indirekte, pa qenë i regjistruar. Është një fushë që kërkon goxha diskutime nga komisioni, por e preka meqenëse nuk u përmend thuajse fare, me përjashtim të zotit Quentin, i cili e përmendi kur dha definicionin e shpenzimeve elektorale: “Shpenzime elektorale duhet të quhen ato shpenzime që bëhen nga kandidatët, por edhe nga palë në emër të partisë”. Pra, ishte diçka që doja ta sillja në vëmendjen e komisionit. Kapitulli “palë të treta” ka nevojë për rregullime, sepse ka boshllëqe.

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Nisur nga ajo që ju sapo thatë, por edhe nga ajo që tha pak më parë zoti Krasniqi, dua t’ju them që ne si komision kemi tentuar të jemi gjithëpërfshirës. Kjo do të thotë që, jo vetëm ju

ftojmë të debatojmë mbi një produkt të një eksperti të caktuar, por ju ftojme të sillni edhe propozime konkrete. Në këtë rast i referohem zotit Krasniqi, i cili me të drejtë, siç e thashë dhe më parë, me një vëzhgim jo sipërfaqësor arriti të bënte një kritikë të propozimeve konkrete të bëra nga eksperti.

Ftoj zotin Krasniqi dhe të gjithë kontribuesit jashtë komisionit të kontribuojnë me propozime konkrete, në mënyrë që të përfshijmë brenda axhendës së miratuar nga komisioni të gjitha sensibilitetet që vijnë nga të gjithë aktorët apo faktorët, të cilët, në një mënyrë apo në një tjetër, ndikojnë në procesin zgjedhor në shqipëri.

Ftesa është e hapur për të gjithë. Për sa i përket rastit konkret, duke e ditur që zoti Krasniqi ka një fokus specifik për çështjen e financimit të partive, mirëpresim që t'i vini në dispozicion komisionit në një kohë sa më të arsyeshme, jo vetëm propozimet e bëra sot në tryezë, por të gjitha propozimet konkrete që keni për çështje të tjera që ndoshta nuk i kemi prekur.

Nëse nuk ka njeri tjetër për të diskutuar, po ia jap fjalën bashkëkryetarit, zotit Bylykbashi, për të dhënë edhe ai disa konstatime të tijat, por ndoshta edhe për të bërë edhe një përmbledhje të kësaj mbledhjeje.

Faleminderit!

Oerd Bylykbashi – Faleminderit, zoti Çuçi!

Së pari, ju falenderoj për angazhimin me kontribute, çështje të ngritura, pyetje, që sigurisht përçojnë sensitivitet, probleme që keni hasur dhe për të cilat kërkoni zgjidhje, apo edhe me sugjerime konkrete, qoftë duke vënë në pikëpyetje zgjidhje që u ofruan në këtë tavolinë. Ky është një kontribut shumë i rëndësishëm për ne. Ashtu siç e tha edhe zoti Çuçi, mirëpresim të na sillni edhe kontribute konkrete të shkruara, për t'ia kaluar më pas vendimmarrjes së komisionit dhe ekspertëve për fazën e draftimit.

Fakti që e ndamë më vete, tregon se është një temë, e cila ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Ajo që ne duhet të kemi kujdes në këtë fazë përmbledhëse të diskutimeve, pavarësisht fazës kur bëhet financimi i partive politike, zgjedhore apo jozgjedhore, ka të bëjë me një element thelbësor për shëndetin e demokracisë. Ka tendenca demonizimi të partive politike, të cilat më pas sjellin populizëm. Partitë politike janë instrumente kushtetuese të sistemit përfaqësues, e për rrjedhojë është shumë e rëndësishme të jenë kolona të

shëndetshme në sistemin tonë të përgjithshëm kushtetues. Financimi i partive politike ndikon drejtpërdrejtë në shëndetin apo sëmundjen e sistemit politik shqiptar.

Në këtë aspekt, nevoja për të rregulluar financimin, për të shmangur skandalet dhe problemet e rënda, abuzimin apo penetrimin e parasë kriminale dhe korruptive, duhet të mos pengojë funksionimin normal të partive politike dhe aktivitetin e tyre.

Një tjetër temë që doli nga ky diskutim, është raporti i financimit publik-privat, për të cilin pati dy qëndrime: njëri qëndrim, që vjen nga opozita, i bërë publik që në vitin 2016, ishte për financimin 100% nga publiku, kurse qëndrimi tjetër ishte për të mbajtur sistemin miks. Në këtë tryezë ne diskutuam për raportin që duhet të ekzistojë midis publikut dhe privatit dhe nevojës për të ulur financimin privat. Ne sot kemi 10-fishin e financimit më të madh publik për një parti individuale.

Ulja e këtij tavani, siç e kuptova nga propozimi i zotit Reed, do të çoj në uljen e shpenzimeve, sepse do të limitojë hapësirën e madhe që kanë parti të caktuara për të thithur fonde në shuma të tilla. Në fakt, jo vetëm është një tavan jorealit dhe jonormal, por do të na çoj edhe drejt rritjes së barazisë së subjekteve. Nëse ne do të kemi një kufizim të këtij tavani, do të jetë më normale që partitë të shpenzojnë brenda limiteve të arsyeshme në mënyrë të barabartë, e për rrjedhojë nuk do të krijohen inbalanca të forta në procesin e fushatës së subjekteve zgjedhore.

Nga ana tjetër, ulja e financimeve private mund të asociohet me disa probleme apo rreziqe, kështu që ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm në vendosjen e balancave. Nëse do të kishim thjesht unin e financimit privat, dhe ndërkohë nuk do të kemi fuqizimin e për rrjedhojë dominimin nga brenda raporteve të financimit publik, thjesht do të linim funksionimin e partive politike pa financat e mjaftueshme për sa kohë financimi publik do të jetë i dobët. Financimi publik mund të jetë i dobët në mënyrë të qëllimshme, sepse ekzekutivit i intereson të jetë kështu. Vendos një shumë totale iks dhe thotë që nuk kam më shumë para.

Ndoshta jemi para nevojës që, ndërkohë që forcojmë dukshëm raportin publik-privat në favor të publikut, duhet të vendosen me ligj rregulla dhe kritere të qarta, të cilat do të bënin përcaktimin e financimeve publike jashtë diskrecionit të ekzekutivit, si një forcë më vete për shkak të gjithë aktivitetit që kryen, e cila do të ndikonte më pas në favor të partive që janë në pushtet.

Një çështje tjetër që mbetet në këtë diskutim, pra, të zgjedhim midis 100% publik apo do të lejojmë një pjesë të jetë privat. Këtu është diskutimi: a do të kemi ndalim të financimit korporativ, siç e kanë shtete të caktuara? Ka shtete që e ndalojnë financimin nga korporatat, duke lejuar vetëm financim të reduktuar, transparent të individëve. Kjo e lidhur me mundësinë për t'u angazhuar në procesin politik të individëve, të drejtën e tyre të shprehjes apo pjesëmarrjes në një proces politik. Por të mos kufizohemi eventualisht vetëm te fakti që subjekte private, jo individë, nëse financojnë më pas nuk marrin tenderë apo kur marrin tenderë përsëri nuk financojnë. A ekziston mundësia të shikojmë një zgjidhje, e cila do të lejonte një raport të kujdesshëm, do të lejonte financimin e individëve, por jo të korporatave? Ka shembuj: Franca, Belgjika dhe vende të tjera kanë arritur në këto konkluzione për faktin se kanë pasur probleme me financimin.

Ne patëm një diskutim këtu në lidhje me transparencën, deklarin që më pas sjell edhe mundësinë e monitorimit, të disiplinimit qoftë edhe të sanksioneve për atë që deklarojnë partitë politike. Duhet bërë kohë më pas, duhet bërë shumë shpejt pas zgjedhjeve? Kjo lidhet me strukturat, resurset që kanë partitë politike të dedikuara, sidomos në periudhë zgjedhore, ku pothuajse çdokush angazhohet në front dhe jo për të mbajtur kontabilitetin. Pse një deklarin i qartë, i mirë, i bërë pak kohë më pas është më pak efikas, mund të ketë mundësi për manipulim që është vepër penale, në fund fare? Pra, ky do të jetë diskutimi, korniza e afateve të arsyeshme, që do të garantonte transparencën maksimale, eliminimin e abuzimeve, por nga ana tjetër dhe mundësitë reale për partitë politike.

Ne patëm edhe diskutimin nëse duhet të bëhet deklarin më përpara, gjatë procesit zgjedhor, gjatë fushatës zgjedhore duhet bërë deklarin i shpenzimeve, deklarin i burimeve të financimit, të dyja bashkë apo jo dhe kjo e bërë me kujdesin për situatën tonë reale. Sot besoj se nuk e ka pothuajse askush të qartë në këtë tryezë që në momentin kur dikush ekspozohet si financues i një subjekti jo në maxhorancë, mund të ekspozohet edhe ndaj kundërgoditjes së instrumenteve të ndryshme të ekzekutivit. Kjo mund të çojë më pas, mund të sjellë si pasojë reduktimin e mundësisë për financim. Kjo është çështje për diskutim, që kërkon një zgjidhje. Na duhet një sistem raportimi, i cili i koncertuar në mënyrë të kujdesshme, jo kakofonik, do të bënte nga ana tjetër të vështirë për subjektet politike, t'u shmanget nëpërmjet formave të ndryshme detyrimeve për raportim. Përfshirja në proces e subjekteve të tjera siç është shoqëria civile, zgjedhësit, e drejta e tyre për të raportuar apo për t'u ankuar për çështje të caktuara e rrit

fluksin e informacionit dhe më pas bën edhe me efikas sistemin e sanksioneve dhe institucionet. Ne mund të përfshijmë më shumë sesa një institucion në këtë proces, siç mund të jenë institucione të tjera shtetërore të cilat marrin informacion në raport me financat që qarkullojnë. Pra, një qasje e koncertuar e vështirë për t'u kontrolluar nga subjektet mund të jetë një mënyrë për të reduktuar fiktivitetin e deklarimeve. Bashkë me këtë lidhet edhe një proces i rëndësishëm që e kryen KQZ-ja: nxjerrjen e akteve rregullatore jo në periudhë zgjedhore, kohë përpara, stabël, pa nevojën për t'u ndryshuar vazhdimisht. Këto rregulla nuk ndryshojnë shpesh, për rrjedhojë qartazi të kuptueshme për subjektet, por që duhet të jenë edhe të thjeshta. Ku? Në mënyrë specifike të formularët, nëse ne do të fusim si instrument të rëndësishëm kontrolli se çfarë deklarojnë në ato formularë. Nga ana tjetër edhe formularët duhet të jenë të tillë që të mos kthehet bishti më i rëndë sesa sqepari. Pra, partitë politike ta kenë mendjen të bëjnë politikë dhe jo të merren me kontabilitet. I gjithë informacioni që është i nevojshëm për institucione si KQZ-ja të jetë i disponueshëm, duke filluar nga ajo që plotëson një nëpunës i thjeshtë i financës i një partie në një degë lokale, kandidati dhe deri te drejtuesit e partive politike.

U ngrit çështja e penalizimit, do të penalizojmë trezorierët, shefat e financave apo do ta çojmë te subjektet zgjedhore? Sot me të drejtë u ngrit çështja se kjo mund të abuzohet, ndërkohë që u sqarua qartë pozicioni se nuk është ky qëllimi, pra të shkohet nëpërmjet abuzimit të cenohen mandatet zgjedhore të subjekteve. Nga ana tjetër kur kjo provohet mund të shikohet edhe mundësia, dhe diskutimi është nëse shihet mundësia për të penalizuar deputetë apo të zgjedhur të tjerë individualisht apo forca politike për të humbur mandatin në rast se provohet që janë përfshirë: në shitblerjen e votës apo financimi ka qenë i paligjshëm. Ka modele për këtë dhe në këtë fazë ne duhet të eksplorojmë më tej zgjidhjet konkrete që na përshtaten.

Kjo tryezë preku në mënyrë natyrale çështje, të cilat nuk janë vetëm të kësaj tryeze. Çështjet kanë të bëjnë me mediet, sepse financimi lidhet drejtpërdrejt me to, çështje që kanë të bëjnë me shitblerjen e votës, çështje që kanë të bëjnë me abuzime të burimeve shtetërore, përfshirë instrumentin tashmë shumë të vjetër të nëpunësit ndërlidhës, që e dimë pak vetë që ekziston, sepse askush nuk e përdor më, por një instrument i futur në vitin 2003 ishte në avangardë dhe tregoi nevojën se burimet shtetërore duheshin frenuar nga abuzimi. Nuk ka ndodhur kurrë. Kemi ardhur në pikën që është rekomandimi prioritar numër 3. Ne duhet të shikojmë një mekanizëm, i cili i bën të nevojshme edhe këto, por këto do të jenë çështje të

tryezave të tjera që vijnë në vijim. Është shumë mirë që dalin këtu, sepse prej këtu mund të bëjmë një diskutim më të informuar në tryezat e tjera.

Financimi në mediet alternative. Sigurisht me të drejtë njerëzit nuk kufizohen më vetëm tek televizori, aq më pak te radioja dhe aq më pak te gazetat e shkruara. Edhe kjo është një sfidë tjetër e vështirë, jo vetëm për Shqipërinë, por që ne duhet ta shikojmë. Këtu u përmend edhe rasti sesi mund të blihet e gjithë koha, hapësira e internetit nga një subjekt politik, duhet ta shikojmë me mendje të hapur, por të paktën të hedhim themelet e zgjidhjeve për këtë çështje.

Për ta mbyllur, çështja e fundit, mund të kem lënë çështje të tjera, por ne do ta filtrojmë të gjithë materialin që del nga kjo mbledhje për të kuptuar çdo element. Është e nevojshme që edhe financimi i palëve të treta të jetë i përfshirë, përtej spekulimeve: ky ka bërë atë. Sot jemi gjithmonë dhe më të ekspozuar karshi këtij fenomeni, por ai ka ekzistuar edhe më parë. Ne kemi prej vitesh OJF të financuara nga donatorë ndërkombëtarë për aktivitete në dukje për demokraci që pak përpara periudhës zgjedhore transformohen në parti politike. Për rrjedhojë e gjithë fushata ndërtohet mbi programin e këtyre subjekteve dhe më pas marrin pjesën. Praktikisht është financuar me burime të huaja në mënyrë fare të paqëllimshme fushata elektorale. Ne kemi fondacione, të cilat operojnë, ka rregullime, por janë të pamjaftueshme. Ne mund të kemi OJF, të cilat bëjnë fushatë nëpërmjet spoteve publicitare, duke reflektuar pothuajse 100% mesazhin politik të subjektit të caktuar. Pra, është një fushë, e cila ndoshta duhet parë me kujdes, sepse është e qartë se ne na mungojnë rregullat për këtë aspekt.

Nuk mendoj se isha ezaurues në çështjet që unë mbajta shënim, si çështje që na vlejnjë për diskutim të mëtejshëm. Sigurisht, nevoja për të pasur një sistem unik, të thjeshtë, lehtësisht të monitorueshëm dhe me sanksione efikase, është pjesë e të gjithë këtij diskutimi.

Në gjykimin tim, kjo tryezë na dha mundësinë të diskutonim çështje të rëndësishme, si dhe të nxjerrim konkluzione shumë të vlefshme, për të shkuar drejt vendimmarrjes në Komisionin e Reformës.

Kolegu Çuçi mund të ketë çështje të tjera për të shtuar. Në këtë aspekt, unë përsëri do të doja të falënderoja zyrën e Këshillit të Europës.

Fatmir Mediu – Për të gjitha diskutimet, unë do t'i lutesha në mënyrë të veçantë zotit Rusmajli, që ato pyetje në formë sugjerimi t'i jepte edhe me shkrim, disi edhe më të elaboruara si mendime, që t'u përcillen komisionit dhe grupit të ekspertëve. Sepse mendoj se disa nga ato

propozime kënaqin, të paktën, këto pritshmëritë tona në raport me financimin e fushatave elektorale, fondet publike apo fondet që vinë nga burime të tjera.

Bledar Çuçi – Faleminderit!

Besoj se ishte ftesë e hapur edhe për më përpara, për zotin Rusmajli, edhe për atë që thashë unë, dhe e mirëpresim. Pa diskutim që janë shumë të vlefshme, sidomos kur vinë nga ekspertë, është pak fjala për këtë rast, por me një bagazh shumë të gjerë edhe në praktikë, edhe në procesin legjislativ, kështu që janë me shumë interes për komisionin.

Unë, zoti bashkëkryetar, nuk kam ndonjë gjë të veçantë për të shtruar, sepse tryeza e sotme pikërisht këtë qëllim kishte, që ne të hedhim të gjithë opinionet, mendimet, ekspertizën, propozimet, së bashku, si komision, por edhe me kontribuuesit e tjerë, të cilët duan të kontribuojnë në këtë reformë. Tani, siç e thashë edhe në fillim, për pikën 4/2 të platformës që ne kemi miratuar, pritet që ne të arrijmë të krijojmë një dokument, i cili do të jetë si një sintezë e qëndrimeve tona politike, si përfaqësues politikë, me ekspertizën e ardhur nga kjo tryezë, me fokus të veçantë referimin të rekomandimet e OSBE/ODIHR-it për tri palë zgjedhjet e fundit. Sepse, në fund të fundit, gjëja që ne kurrsesi nuk duhet ta anashkalojmë apo tolerojmë, është që, minimumi që do të bëjmë, të jetë pikërisht arritja e reflektimit të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, pastaj, sigurisht, ta zhvillojmë më tej, për të përmirësuar sistemin, nisur nga të gjithë eksperiencat që kemi pasur gjatë këtyre njëzet e kusur viteve në proceset zgjedhore.

Duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrjen dhe kontributin, ju them se mbledhja tjetër do të lajmërohet shumë shpejt dhe do të vazhdojë me pikat e tjera të axhendës.

MBYLLET MBLEDHJA